



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 4/2015

**MENAXHIMI I PATRULLIMEVE NË TRAFIK
DHE SIGURISË NË RRUGË**



(KORRIK 2015)

**Aprovuar
Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**

SHKURTESAT

<i>DPP</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë</i>
<i>DRP</i>	<i>Drejtoria Regjionale e Policisë</i>
<i>IPK</i>	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>
<i>MPB</i>	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>
<i>PK -së</i>	<i>Policia e Kosovës</i>
<i>BNJ</i>	<i>Burimet Njerëzore</i>
<i>NJRKRR</i>	<i>Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor</i>
<i>NJKA</i>	<i>Njësia për Kontrollin e Autosdradave</i>
<i>KKSB</i>	<i>Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi</i>
<i>KLSP</i>	<i>Këshilli Lokal për Siguri Publike</i>

P Ë R M B A J T J A

1. Përmbledhja Ekzekutive.....(4-5)
2. Hyrje.....(6-7)
3. Organizimi dhe funksionimi i njësive policore në fushën e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë.....(8-21)
4. Vlerësimi i politikave policore në marrjen e masave pro-aktive në drejtim të ngritjes së sigurisë.....(21-26)
5. Analizimi dhe vlerësimi i pajisjeve të njësive operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operationale për patrullim.....(26- 30)
6. Përfundimi.....(31- 32)
7. Rekomandimet(32- 33)
8. Plani i Veprimit për implemtim të rekomandimeve.....(34-37)

1. Përmbledhje Ekzekutive

1.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, paragrafi 2, autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë një Inspektim të rregullt në fushën e "Menaxhimi i Patrullimeve në trafik dhe Siguria në Rruge" Inspektimi në këtë fushë është shtrirë në strukturën policore dhe si tillë ka përfshirë: Divizionin e Sigurisë Publike, 7 Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës (Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor) dhe 40 Stacione Policore.

1.2 Sipas Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës në fuqi, (të datës 25 maj 2012) përgjegjës për menaxhimin e patrullimeve dhe ofrimin e sigurisë në rrugë në tërë territorin e vendit është Departamenti për Operacione në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, Divizioni Për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës dhe Stacionet Policore. Shiqar në përgjithësi përmbushja dhe funksionalizimi i strukturës organizative me burime njerëzore është e kënaqshme edhe pse ka disa mangësi nëpër stacione dhe njësi veç e veç. Inspektimi ka vënë në pah se tek disa stacione të kategorisë A, B dhe C nuk është i përmbushur standardi për minimumin dhe maksimumin e personelit. Disa stacione kanë personel me pak se minimumi i përcaktuar, e disa tjera e tajkalojnë maksimumin e numrit të personelit të përcaktuar.

1.3 Njësitet kompetente për zbatimin e aktivitetit patrullues në terren varësisht prej nevojave proaktive të aplikimit brenda zonës së përgjegjësisë aplikojnë metodologjinë e patrullimit me vetura, patrullimi në këmbë si dhe varësisht nga sezona aplikohet edhe patrullimi me biçikleta. Nëpër disa stacione policore për shkak të mungesës së personelit adekuat të trajnuar për patrullim me biçikleta nuk është arritur që kjo njësi të jetë funksionale në të gjitha stacionet policore. Poashtu nëpër NJRKRR-të për shkak të mungesës së pajisjeve me motoçikleta si dhe mungesës së stafit adekuat të trajnuar nuk janë funksionale njësi të motorçikletave nëpër të gjitha këto njësi.

1.4 Ndarjen e Drejtoritve Regjionale i përcaktojnë karakteristikat si: hapësira gjeografike e zonës së përgjegjësisë, numri i banorëve, ngarkueshmëria e rasteve të trajtuara nga policia si dhe numri i fuqisë punëtore të angazhuar. Në kuadër të drejtorive regjionale, stacioneve policore dhe njësi, janë të angazhuar në total 2.068 zyrtar policor të informuar. Shikuar për nga numri i banorëve në raport për numrin e policëve të angazhuar, DRP-Ferizaj, DRP Prizren, DRP-Peja janë drejtoritë më të ngarkuara në këtë aspekt në me mbi 1000 banor për zyrtar policor. Ndërsa në anën tjetër DRP- Prishtinës për shkak të karakteristikave si kryeqytet i vendit, numrit tejet të madh të rasteve, e bënë atë si drejtorinë më të ngarkuar në me mbi 42 raste për zyrtar policor.

1.5 Për menaxhimin e patrullimeve dhe ofrimin e sigurisë në rrugë në tërë territorin e vendit Departamenti për Operacione në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive qendrore, nxjerrjen e Urdhërave Operative që garantojnë arritjen e synimeve dhe realizim të objektivave të përcaktuara nga organizata e PK-së. Drejtoritë Rajonale për realizimin dhe materializimin e strategjive dhe planeve strategjike hartojnë plane operative të karakterit regional me përfshirje të njërive dhe stacioneve që janë në varshmërinë e tyre. Niveli lokal i stacioneve policore nxjerrë plane operative të cilat i zbaton me kapacitetet e veta që kanë brenda zonës së tyre të përgjegjësisë

1.6 Gjatë vitit 2014, stacionet policore në kuadër të aktivitetit proaktiv në drejtim të ngritjes së sigurisë kishin qenë të angazhuara në aktivitete policore në mbulimin e zonës së përgjegjësisë së tyre. Nëpër stacione policore, gjatë kësaj periudhe ka pasur në total 2.370 plane operative nga së paku 4 plane e deri më së shumti 437 për stacion policor. Janë realizuar gjithsejt 126.082 patrullime dhe atë nga më së paku nga 725 patrullime e deri më së shumti nga 4.620 sosh.

Gjatë vitit 2014 gjithsej janë trajtuar 128.605 kundërvajtje, nga me së paku nga 25 kundërvajtje e deri më së shumti 13.408 për stacion policor. Si dhe janë trajtuar në total 9.781 aksidente trafiku nga me së paku nga 3 aksidente e deri më së shumti nga 1.334 për stacion policor. Gjatë vitit 2014 stacionet policore dhe njësitë rajonale të komunikacionit rrugor kishin hartuar një mori planesh operative, programe të ndryshme edukative dhe vetedijësuese me partneritet me shkollat. Ndërsa nëpër stacionet policore të rendit janë angazhuar njësi policore të veçanta për tu kujdesur për sigurinë nëpër shkolla dhe hapësirat rreth tyre.

1.7 Po ashtu gjatë vitit 2014, njësitë rajonale të komunikacionit rrugor dhe NJKA në kuadër të aktivitetit proaktiv në drejtim të ngritjes së sigurisë kishin qenë të angazhuara në mbulimin e zonës së përgjegjësisë së tyre nëpër rrugët rajonale magjistrale dhe respektivisht në autostradë. Nga këto njësi, gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur në total 236 plane operative nga së paku 18 plane operative e deri me së shumti 53 për njësitë rajonale të komunikacionit rrugor dhe NJKA. Janë realizuar gjithsejtë 68.716 pika kontrolli dhe atë nga me së paku nga 3.950 e deri më së shumti nga 11.306. Gjatë vitit 2014, gjithsej janë shqiptuar 195.039 kundërvajtje trafiku nga më së paku 1.946 e deri më së shumti 42.870. Si dhe janë trajtuar në total 6.507 aksidente trafiku nga me së paku nga 134 aksidente e deri më së shumti nga 2992 për njësitë rajonale të komunikacionit rrugor dhe NJKA.

1.8 Pa dyshim se për vlerësimin e performancës së zyrtarëve policor ndikojnë edhe kushtet e punës dhe pajisjet me të cilat ata punojnë. Nëse shikohet gjendja ekzistuese me pajisje varësisht nga regjioni apo njësia situata ndryshon ngase nuk duket të ketë një shpërndarje dhe aq proporcionale me pajisje për punë. Gjatë inspektimit është vërejtur se diku 50% të automjeteve policore janë jashtë funksionit për qarkullim dhe të njëjtat ndodheshin në autoparkun e servisit të Policisë së Kosovës. Diku 27% e biçikletave me të cilat janë të ngarkuara stacionet janë jo funksionale. Po ashtu edhe 48% alkotesteve, 36% e kamerave digjitale dhe 37% e laserëve (radareve) rezultojnë të jenë në gjendje jofunksionale për punë. Të gjitha këto ndikojnë në rezultatet punës së njërive patrulluese dhe në performancën e policisë së Kosovës.

1.9 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 29.07.2015, ka mbajtur takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse, kurse me datën 12.08.2015 IPK-ja ka pranuar nga Divizioni për Siguri Publike, Planin e Veprimit në Realizimin e Rekomandimeve, në të cilin është konstatuar se disa nga rekomandimet do të implementohen në periudha të parapara kohore e disa tjera kërkojnë implementim në periudha më të gjata kohore.

2. Hyrje

2.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, paragrafi 2, autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të zakonshëm në Policinë e Kosovës. Inspektimi u funksionalizuar nga inspektorët policor të Departamentit të Inspektimit dhe është zhvilluar nga data 16 mars deri me 28 prill 2015.

2.2 Patrullimi policor përben segmentin më me rendësi dhe me të shtrenjtë të organizatës policore. Asnjë shërbim i specializuar nuk i kontribuon më shumë reputacionit dhe ngritjes së besimit të policisë tek qytetarët sesa shërbimi efektiv dhe efikas i njësiteve patrulluese. Inspektimi në fushën e menaxhimit të patrullimeve në trafik dhe siguria në rrugë luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në menaxhimin e patrullimeve në trafik ;
- Ngritjen e shkallës së sigurisë si rezultat i patrullimeve brenda zonës së përgjegjësisë;
- Ngritjen e bashkëpunimit dhe kultivimin raporteve të mira në mes policisë dhe akterëve tjerë relevant mbi sigurinë në rrugë.
- Ngritjen e besimit të qytetarëve tek Policia e Kosovës.
- Të jepen rekomandime për përmirësimin e performancës policore, ngritje e nivelit të profesionalizmit dhe disiplinës tek zyrtarët policore gjatë kryerjes së detyrave policore.

2.3 Objektivi që synon të arrij ky inspektim janë:

- Vlerësimi i organizimit dhe funksionimit të njësive policore dhe burimeve të tyre që merren me patrullimet në trafik dhe sigurinë në rrugë;
- Vlerësimi i politikave policore në marrjen e masave pro-aktive në drejtim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor dhe patrullimeve në trafik;
- Analizimi dhe vlerësimi i pajisjeve të njësive operative dhe mjeteve të nevojshme operacionale për patrullim;

2.4 Ky inspektim sa i përket analizimit të të dhënave statistikore të aktiviteteve policore si dhe performancës policore mbulon periudhën kohore gjatë vitit kalendarik 2014, ndërsa vlerësimi të gjendjes me pajisjet e njësive policore fokusohet në periudhën kohore gjatë së cilës kryhet inspektimi.

2.5 Dokumentet në vijim do të jenë baza në të cilën do të mbështetet puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të detyrave policore në drejtoritë gjegjëse:

- Ligji i Policisë;
- Doracak i Parimeve dhe Procedurave të PK-së
- Ligji Nr. 02/L-70 Për Sigurinë në Komunikacionin rrugor;
- Udhëzuesi për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave në Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e komunikacionit Rrugor (Ref. NDO-04/3-019/2012);
- Procedurat Standarde të Operimit që mbulojnë fushën e detyrave dhe përgjegjësisë të policisë në Sigurinë në Komunikacionin Rrugor

2.6 Inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm:

- Ngritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në menaxhimin e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë
- Përmirësimin e kryerjes së detyrave policore duke siguruar ngritje të performancës

policor në harmoni me standardet e kërkuara.

- Identifikimin dhe parandalimin e parregullsive gjatë procedurave të kryerjes së detyrave policore dhe ngritjen e nivelit të profesionalizmit
- Ngritjen e nivelit të profesionalizmit, përgjegjësisë dhe disiplinës të zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrave policore.

2.7 Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është aplikuar metodologji e punës e kombinimit të intervistave me zyrtarët kompetent për fushën që inspektohet, kontrollimi fizik i dokumentacionit të shkruar relevant gjatë procesit të inspektimit brenda periudhës që i kushtohet inspektimi. Inspektimi ka përfshi metodë të kombinuar të inspektimit të performancës dhe përputhshmërisë me bazën ligjore. Kurse trajtimi i fushës është fokusuar vetëm në mënyrat e patrullimeve duke mos trajtuar në veçanti qështjën e angazhimeve tjera që kanë zyrtarëve policor të kësaj njësie policore.

Për shpjegime të mëtejme fusha e inspektuar ka trajtuar vetëm menaxhimet e patrullimeve në trafik dhe ofrimi i sigurisë në rrugë duke ndarë qështjen e trajtimit të angazhimeve të sektorëve policor të cilat janë temë e startegjisë së Policimit në Bashkësi dhe e cila pjesë do të trajtohet me fokus të veçantë në një fushë tjetër inspektuese.

2.8 Inspektimin në këtë fushë është shtrirë në Strukturën policore dhe si i tillë ka përfshirë:

Departamentin për Operacione, Drejtoritë Rajonale, Stacionet Policore, Njësitë Regjionale të Komunikacionit Rrugor dhe Njësinë për Kontrollin e Autostradave. Gjatë inspektimit personeli i IPK-së ka intervistuar zyrtarët si në vijim:

- Drejtori i Departamentit për Operacione;
- Drejtori i Divizionit për Siguri Publike;
- Drejtorët e Drejtorive Rajonale të Policisë;
- Komandantet e Stacioneve Policore;
- Shefat e Njësisë Rajonale të Komunikacionit Rrugor;
- Shefi i Njësisë për kontrollin e Autostradave;

3. Organizimit dhe funksionimi i njësive policore në fushën e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë

3.1 Patrullat policore zakonisht janë një grup i caktuar i zyrtarëve policor të cilët kanë për detyrë që të monitorojnë një zonë të caktuar gjeografike. Policia e Kosovës me qëllim për të zbatuar përgjegjësitë ligjore përmes patrullimeve kanë caktuar monitorimet në zonat e specifikuara gjeografike, në të cilat zyrtarët policor duke lëvizur nëpër këto zona në intervale të ndryshme kohore qëndrojnë në kërkim të identifikimit të qfarëdo natyre të problemeve. Andaj zyrtarët policor patrullues janë ata që hasën më së shpeshti nga publiku ku si detyra të tyre kanë përgjigjet e thirrjeve për shërbime policore duke bërë arrestime, marrje të informacioneve lidhur me krimet, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, zbatimin e ligjeve sa i përket përgjegjësive në trafik, si dhe masa të tjera për parandalimin e krimit. Për shpjegime të mëtejme patrullat policore në të shumtën e rasteve janë të parat që arrijnë në vendin e ndonjë incidenti dhe rezultati i angazhimit të tyre mund të ndikojë në masë të madhe në rezultatin e hetimeve të mëvonshme.

3.2 Organizimi dhe funksionimi i njësive policore në fushën e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë rrjedhë si përputhshmëri me strukturën organizative të PK-së, si dhe rregullativës ligjore që rregullon fushën përkatëse dhe e cila është e harmonizuar me Ligjin për Policinë (2011/04-L-076) dhe Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor (2007/02-L70). Si akt nënligjore në fuqi lidhur më fushën në fjalë janë: Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 Për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Autorizimeve Policore, Doracakun e Parimeve dhe Proceduarave Seksioni V, Parimi P-5.10 Patrullimi si dhe Procedura Standarde e Operimit Njësiti Rajonale të Komunikacionit Rrugor Nr. Ref 04/3/387/2014, si dhe një numër i konsiderueshëm e i PSO-ve për implementimin e Strategjisë Policimi në Bashkësi (metodologji e patrullimit që zbatohet nga njësiti sektoriale nëpër stacione policore).

3.3 Për kryerjen e aktiviteteve policore në fushën e patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë Policia e Kosovës brenda strukturës së saj organizative ka të funksionalizuar, Departamentin për Operacione, i cili ka në varësi të tij Divizionin Për Siguri Publike, Divizionin e Komunikacionit Rrugor, NJRKRR, dhe NJKA të cilat angazhimin e tyre e mbështesin në Ligjin e Policisë së Kosovës, Ligjin për Siguri në Komunikacionin Rrugor, Udhëzuesin për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave në Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Komunikacionit Rrugor, Doracakun e Parimeve dhe Procedurave të PK-së, dhe Procedura Standarde e Operimit/ Përshkrimi i Vendeve të Punës. Kështu që të gjitha këto njësi policore funksionet patrulluese të tyre në përmbajtje i kanë të ndara në kategorinë e parandalimit të krimit si detyrë proaktive, zbatim të ligjit si detyrë reaktive, mirëmbajtje të rendit dhe qetësis publike në fushën e sigurisë dhe si shërbime qytetare që kanë të bëjnë me mirëqenjen e komunitetit.

3.4 Sipas Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës në fuqi, (të datës 25 maj 2012) përgjegjës për menaxhimin e patrullimeve dhe ofrimin e sigurisë në rrugë në tërë territorin e vendit është Departamenti për Operacione në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, në varësi të të cilit janë Divizioni për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës dhe Stacionet Policore.

3.5 Në përputhje me kufijtë gjeografik rajonal janë të përcaktuara dhe zonat e përgjegjësive për Drejtoritë Rajonale të Policisë. Varësisht nga karakteristikat gjeografike, demografike dhe veçorive tjera janë shpërndarë kapacitet e burimeve njerëzore. Gjatë vitit 2014 organizimi i policisë ka përfshirë shtatë (7) Drejtoritë Rajonale: DRP-Prishtinë, DRP-Prizren, DRP-Pejë, DRP-Mitrovicë Jugu, DRP-Mitrovicë Veriu, DRP-Gjilan dhe DRP-Ferizaj të cilat kanë nën varshmërinë e tyre dyzet (40) stacione policore. Vlen të theksohet që brenda drejtorive rajonale përveq stacioneve policore funksionojnë edhe 21 nën stacione policore por të cilat nuk

kanë qenë pjesë e këtij inspektimi. Po ashtu brenda Drejtorive Rajonale Policore angazhimet në detyrat e patrullimeve dhe sigurisë në rrugë i zhvillojnë edhe Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor. Vlen të theksohet që ky organizim ka ndryshuar në tremujorin e vitit 2015, për shkak të ristrukturimit të fundit ku është krijuar edhe Drejtoria Rajonale e Gjakovës, gjë e cila ka ndikuar në ndryshimin e karakteristikave nga dy drejtoritë rajonale atë të Prizrenit dhe Pejës.

3.6 Për më tutje Drejtoritë Rajonale Policore për shkak të specifikave kanë dallime sa i përket numrit të Stacioneve Policore ku, DRP-Prishtinë përbëhet nga nëntë (9) Stacione Policore, DRP-Prizren katër (4), DRP-Pejë pesë (5). DRP –Mitrovica Jugu- (3), DRP-Mitrovicë Veriu katër (4), DRP-Gjilanë shtatë (7), DRP-Ferizaj pesë (5) dhe DRP-Gjakovë tri (3) Stacione Policore. Në të gjitha Drejtoritë Rajonale, Stacionet Policore janë të kategorizuara si stacione A,B,C, të cilat dallojnë njëra nga tjetra në aspektin e numrit të personelit. Vlen të theksohet që numri i personelit tek të gjitha kategoritë e Stacioneve Policore ka të përcaktuar minimumin dhe maksimumin e zyrtarëve policor. Kështu që Stacionet Policore të kategorisë A kanë të përcaktuar si minimum 117 dhe maksimum 165 zyrtarë policor, kategoria B kanë prej 56 deri në 116 zyrtarë policor , dhe kategoria C nga 20 deri në 55 zyrtarë policor.

3.7 Për shpjegime të mëtejme Stacioni Policor Mitrovica e Veriut dhe Leposaviq në përputhje me strukturën organizative janë të kategorizuara në stacione të kategorisë B. Mirëpo në kohën e inspektimit funksionet e tyre i kanë zhvilluar si stacione policore të kategorisë A, gjithnjë duke vepruar në mënyrë analoge me mënyrën e organizimit të Drejtorisë Rajonale Mitrovicë Jugu. Andaj referuar kësaj qështje në të dhënat e këtij raporti këto dy stacione janë të vendosura si në mënyrën e funksionimit gjatë kohës së inspektimit. Kështu që Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës gjerë në kohën e inspektimit nuk ka arritur që të precizoi kategorizimin e Stacioneve Policore në Drejtorinë Rajonale Mitrovicë Veriu konform kategorizimeve strukturore.

3.8 Inspektimi ka vënë në pah se tek disa stacione të kategorisë A, B dhe C nuk është i përmbushur standardi për minimumin dhe maksimumin e personelit. Kështu që stacionet policore të kategorisë A siç janë Stacioni Policor Veriu-Prishtinë prej 117 zyrtarëve policor të përcaktuar si minimum ajo ka në funksion aktualisht vetëm 101 zyrtarë policor, kurse Stacioni Policor i Prizrenit ka tejkaluar standardin ku nga maksimumi prej 165 zyrtarëve policor në funksionimin aktual ka 178 zyrtarë policor.

3.9 Stacionet Policore të kategorisë B, siç është Dragashi nga minimumi i përcaktuar prej 56 zyrtarëve policor, vepron në aktualitet vetëm me 51 zyrtarë policor, deri sa Stacioni Policor i Vushtrrisë ka tejklaur numrin e përgjithshëm të maksimumit ku nga 116 sa duhet të ketë ai shfrytëzon 119 zyrtarë policor. Kurse tek stacionet policore të kategorisë C, vetëm Stacioni Policor i Hanit te Elezit nga minimumi prej 20 zyrtarëve policor që duhet të ketë në dispozicion ai posedon vetëm 16 nga ta, apo Stacioni Policor në Mamushë nga minimumi 20 zyrtarëve policor ka vetëm 17 sosh. Vlen të theksohet që trajtimi i çështjes së mos plotësimit të personelit të përgjithshëm të Stacioneve Policore në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në shprëndarje të mirëfilltë të tij në fushën e patrullimeve. Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e shprëndarjes së personelit në raport me numrin e përcaktuar të personelit sipas kategorizimit dhe të atyre që janë aktual.

Tabela nr. 1. Karakteristikat për SP të PK-së sipas organizimit, shpërndarjes së BNJ në raport me numrin e përcaktuar të kategorizimit dhe të atyre që janë aktual.

Stacioni (A)	Polic të përcaktuar		Polic aktual në funksion
	Min	Max	
<i>Ferizaj</i>	117	165	144
<i>Gjakovë</i>			188
<i>Gjilan</i>			170
<i>Leposaviq</i>			120
<i>Mitrovica e Jugut</i>			119
<i>Mitrovica e Veriut</i>			132
<i>Pejë</i>			163
<i>Prishtinë Jugu</i>			131
<i>Prishtinë Qendra</i>			148
<i>Prishtinë Veri</i>			101
<i>Prizren</i>			178
Kategoria B			
<i>Deçan</i>	56	116	60
<i>Dragash</i>			51
<i>Drenas</i>			87
<i>Fushë Kosovë</i>			88
<i>Istog</i>			69
<i>Kamenicë</i>			92
<i>Kaçanik</i>			61
<i>Klinë</i>			79
<i>Lipjan</i>			101
<i>Malishevë</i>			71
<i>Podujevë</i>			74
<i>Rahovec</i>			58
<i>Skenderaj</i>			96
<i>Suharekë</i>			93
<i>Shterpc</i>			59
<i>Viti</i>			89
<i>Vushtrri</i>			119
<i>Zveçan</i>			60
<i>Zubin Potok</i>			69
Kategoria C			
<i>Graçanicë</i>	20	55	44
<i>Hani i Elezit</i>			16
<i>Junik</i>			23
<i>Klllokot</i>			22
<i>Obiliq</i>			45
<i>Mamushë</i>			17
<i>Novoberdë</i>			34
<i>Partesh</i>			21
<i>Ranilug</i>			23
<i>Shtime</i>			48

3.10 Shikuar për nga numri i banorëve në raport për numrin e policëve të angazhuar, DRP-Ferizaj, DRP Prizren , DRP-Peja janë drejtoritë më të ngarkuara në këtë aspekt. Ndërsa në anën tjetër DRP- Prishtinës për shkak të karakteristikave si kryeqytet i vendit, numrit tejet të madh të rasteve, e bënë atë si drejtorinë më të ngarkuar dhe me nevojë të trajtimit më adekuat sa i përket ndarjes dhe angazhimit të resurseve si me personel ashtu edhe me pajisje për punë. Gjatë vitit 2014, në të gjitha stacionet dhe njësitet e kësaj drejtorie ka pasur **20.800** raste të iniciuar të cilat në përpjesëtim me numrin e zyrtarëve policor i bien **42.79** raste për polic, deri sa drejtoria e Mitrovicës së Veriut ka qëndruar me më pak raste në përpjestim me numrin e zyrtarëve policor ku nga **701** raste sa ka pasur të iniciuara i bie të ketë pasur **2.61** raste për polic. Shikuar në nivel vendi gjatë periudhës së vitit 2014 ka pasur gjithsejtë **50.848** raste të iniciuara me mestat **24.58** raste për polic. (Shih tabelen nr. 2):

Tabela nr. 2 Karakteristikat për Drejtoritë Rajonale të PK-së sipas organizimit, shpërndarjes së burimeve njerëzore ne raport me numrin e banorëve, zonën e përgjegjesisë dhe numrin e rasteve për vitin 2014 ¹							
DRP	Polic	Banorë	B/P	KM ²	KM ² /P	Raste	R/P
Prishtina	486	469.472	966	2.470	5,08	20.800	42.79
Prizreni	354	387.828	1.096	2003	5,66	7.291	20.60
Peja	250	311.822	1.247	2.218	8.87	8.712	34.84
Mitrovica J	210	192.799	918	1.072	5.10	4.693	22.34
Mitrovica V	268	79.331	296	1.005	3.75	701	2.61
Gjilani	294	187.417	637	1.206	4.10	4.515	15.35
Ferizaj	206	254.948	1.237	1.219	5.91	4.136	20.07
Gjithsej	2.068	1.883.617	910.8	11.193	5.41	50.848	24.58

Vërejtje: Numri i zyrtarëve policor në tabelë nuk përfshin numrin e përgjithsëm të tyre në drejtori, por përfshinë vetëm policët e sektorëve, dhe ekipeve patrulluese.

3.11 Ndërsa karakteristikat për kategorizimin e Stacioneve Policore gjatë inspektimit në terren kanë vënë në pah se në disa stacione ky kategorizim nuk i përgjigjet nevojave dhe obligimeve që ballafaqohen stacionet e caktuara. Andaj, nëse shikohen dhe analizohen thellë këto karakteristika ka stacione të caktuara për të cilat ka nevojë të rishqyrtohet kategorizimi i tyre në mënyrë me adekuate. Sipas karakteristikave gjeografike të hapësirës së zonës dhe numrin e banorëve brenda zonës së përgjegjesisë në disa stacione kategorizimi nuk i përgjigjet të jenë të kategorizuar si kategori **B** ngase kërkon numër më të madh të personelit policor për ti mbuluar obligimet policore (rasti në Stacionet Policore, Podujevë dhe Suharekë). Në tabelën në vijim pasqyrohet shpërndarja e personelit në raport me kilometrat katrorë në përgjegjësi të Stacioneve Policore dhe rasteve të trajtura.

¹ Të dhënat e siguruara nga Drejtoritë Rajonale Policore;

Tabela nr. 3. Karakteristikat për SP të PK-së sipas organizimit, shpërndarjes së BNJ zonën e përgjegjës dhe numrin e rasteve për vitin 2014

Stacioni	Polic	KM ²	KM ² /P	Raste	R/P
<i>Ferizaj</i>	144	544	3.77	2913	20.2
<i>Gjakovë</i>	118	586	4.96	2096	17.7
<i>Gjilan</i>	170	392	2.30	2205	12.9
<i>Leposaviq</i>	120	536	4.46	131	1.1
<i>Mitrovica e Jugut</i>	119	331	2.78	1883	15.8
<i>Mitrovica e Veriut</i>	132	5	0.03	400	3.0
<i>Pejë</i>	163	392	2.40	3450	21.1
<i>Prishtinë Jugu</i>	131	44	0.33	4394	33.5
<i>Prishtinë Qendra</i>	148	13	0.08	4327	29.2
<i>Prishtinë Veri</i>	101	338	3.34	1897	18.7
<i>Prizren</i>	178	608	3.41	3684	20.7
Kategoria B					
<i>Deçan</i>	60	294	4.9	763	12.7
<i>Dragash</i>	51	435	8.52	397	7.7
<i>Drenas</i>	87	275	3.17	1093	12.5
<i>Fushë Kosovë</i>	88	84	0.95	1.491	16.9
<i>Istog</i>	69	453	6.56	855	12.3
<i>Kamenicë</i>	92	523	5.68	596	6.4
<i>Kaçanik</i>	61	210	3.44	517	8.4
<i>Klinë</i>	79	308	3.90	821	10.4
<i>Lipjan</i>	101	338	3.34	1.580	15.6
<i>Malishevë</i>	71	305	4.29	731	10.3
<i>Podujevë</i>	74	630	8.51	1605	21.7
<i>Rahovec</i>	58	282	4.86	605	10.4
<i>Skenderaj</i>	96	374	3.89	672	7.0
<i>Suharekë</i>	93	361	3.88	1.059	11.4
<i>Shterpc</i>	59	247	4.18	163	2.76
<i>Viti</i>	89	300	3.37	840	9.4
<i>Vushtrri</i>	119	345	2.90	1429	12.0
<i>Zveçan</i>	60	122	2.03	117	1.95
<i>Zubin Potok</i>	69	335	4.85	53	0.76
Kategoria C					
<i>Graçanicë</i>	44	131	2.97	602	13.6
<i>Hani i Elezit</i>	16	83	5.18	119	7.4
<i>Junik</i>	23	77	3.34	63	2.7
<i>Klllokot</i>	22	23	1.04	78	3.5
<i>Obiliq</i>	45	104	2.31	646	14.3
<i>Mamushë</i>	17	12	0.70	52	3
<i>Novoberdë</i>	34	204	6.00	106	3.1
<i>Partesh</i>	21	103	4.90	68	3.2
<i>Ranilug</i>	23	76	3.30	83	3.6
<i>Shtime</i>	48	134	2.79	424	8.8

3.12 Vlenë të theksohet që të gjithë zyrtarët policor nëpër Stacionet Policore përveq patrullimeve në trafik për të ofruar siguri në rrugë në detyrat e tyre të përditshme realizojnë edhe një mori aktiviteteve të tjera siç janë angazhimi në detyra që dalin nga urdhërat operativ, planet operative qoftë nga DRP ashtu dhe nga Stacionet Policore, asistime me të cilat i mbështesin institucionet tjera në vend, protesta, etj.

3.13 Po ashtu stacionet policore të të gjitha Drejtorive Rajonale Policore në organizimin e tyre kanë të aktivizuar sektorët policore, të cilat janë të organizuar në mënyra të ndryshme, deri sa të gjitha ekipet reaguese janë të ndara në mënyrë të njëjtë, nga 4 ekipe si A,B,C,dhe D. Sekorët e Stacioneve Policore gjatë punës së përditshme realizojnë planifikimet e patrullimeve të cilat janë të ndara në patrullime me automjete dhe patrullime në këmbë. Ndërsa ekipet reaguese kryen funksione të kategorisë së zbatimit të ligjit si masë reaktive policore pasi që këto ekipe zakonisht veprojnë pas marrjes së informatës se ka ndodhur ndonjë rast e që hyn

në përgjegjësitë e detyrave policore. Mirëpo duhet theksuar që në disa stacione policore vepron edhe njësia e biciklistave të cilat po ashtu realizojnë patrullime policore.

Foto 1. Pika e kontrollit gjate patrullimit me veturë



3.14 Të gjitha Stacionet Policore të kategorisë A, janë angazhuar për të ndërmarrë veprime patrulluese qoftë me automjete ashtu dhe në këmbë me qëllim që të ofrohet siguria në rrugë. Mirëpo referuar të dhënave të prezentuara nga Stacionet Policore është identifikuar që Stacioni Policor Prizren në dy kategoritë e patrullimeve atë me automjete si dhe në këmbë, në raport me stacionet tjera policore të kategorisë A, ka qenë më i angazhuar në aktivitete patrulluese duke realizuar **3150** patrullime me automjetet kurse më pak aktivitete patrulluese me automjete ka realizuar Leposaviqi me **924** patrullime. Kurse Stacioni Policor Mitrovica Veriu ka ndërmarrë numër më të madh të aktiviteteve patrulluese në këmbë duke i realizuar **3521** patrullime në këmbë por numër dukshëm më të vogël në kategorinë e patrullimeve në këmbë ka realizuar Stacioni Policor Veriu Prishtinë me vetëm 388 patrullime.

Foto 2. Patrullimi në këmbë



3.15 Tek Stacionet Policore të kategorisë B, të dhënat tregojnë se Stacioni Policor Skenderaj ka ndërmarrë numrin më të madh të aktiviteteve patrulluese me automjete duke realizuar **4200** patrullime, kurse Stacioni Policor Lipjan ka ndërmarrë numër më të madh të aktiviteteve patrulluese në këmbë duke i realizuar **5157** patrullime. Ndërsa Stacioni Policor Zubin Potok ka më pak patrullime si në kategorinë e patrullimeve me automjete duke i realizuar vetëm **310** patrullime ashtu edhe atë në këmbë duke i realizuar vetëm **415** patrullime.

3.16 Ndërsa sa i përket Stacioneve Policore të kategorisë C të dhënat pasqyrojnë Se Stacioni Policor Shtime në raport me stacionet tjera të kësaj kategorie, ka ndërmarrë numrin më të madh të aktiviteteve patrulluese me automjete duke i realizuar **1105** patrullime, kurse në kategorinë e patrullimit këmbë stacioni i Obiliqit ka shënuar aktiviteti më të madh në këtë kategori me **1725** patrullime. Derisa të dhënat tregojnë se Stacioni Policor Mamushë ka realizuar më pak patrullime në kategorinë e patrullimeve me automjete duke i realizuar **294** patrullime kurse Stacioni Policor Novoberdë ka realizuar më pak patrullime në këmbë dhe atë në **497** patrullime. Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat lidhur me numrin e zyrtarëve policor në raport me angazhimet në patrullimet me automjete, dhe këmbë.

3.17 Përveq tjerash disa Stacione Policore zhvillojnë aktivitete patrulluese përmes njësisë së biçiklistave të cilat zakonisht këto aktivitete patrulluese i realizojnë gjatë sezonës së verës e të cilat kanë për qëllim që të mbulohet menaxhimi i trafikut dhe të ofrohet siguri në rrugë.

Foto 3. Patrullimi më bicikleta



Tabela nr. 4. Numri i zyrtarëve policor në raport me angazhimet në patrullimet me automjete, dhe këmbë ² .			
Stacioni	Polic	Patrullime me automjete	Patrullime në këmbë
Kategoria A			
<i>Ferizaj</i>	76	1929	1347
<i>Gjakovë</i>	52	1186	1864
<i>Gjilan</i>	106	2109	2063
<i>Leposaviq</i>	77	924	3441
<i>Mitrovica e Jugut</i>	65	2082	1272
<i>Mitrovica e Veriut</i>	128	1113	3521
<i>Pejë</i>	90	3060	2040
<i>Prishtinë Jugu</i>	81	1115	3228
<i>Prishtinë Qendra</i>	87	1246	2820
<i>Prishtinë Veri</i>	45	2706	388
<i>Prizren</i>	137	3150	3270
Kategoria B			
<i>Deçan</i>	39	709	678
<i>Dragash</i>	36	1413	1234
<i>Drenas</i>	66	2113	2861
<i>Fushë Kosovë</i>	50	1320	1237
<i>Istog</i>	47	1111	1085
<i>Kamenicë</i>	63	2375	1315
<i>Kaçanik</i>	44	1530	1153
<i>Klinë</i>	56	2137	862
<i>Lipjan</i>	51	2412	5157
<i>Malishevë</i>	48	2238	1318
<i>Podujevë</i>	38	1167	693
<i>Rahovec</i>	46	1431	740
<i>Skenderaj</i>	63	4200	2356
<i>Suharekë</i>	74	1867	1387
<i>Shterpc</i>	38	803	1075
<i>Viti</i>	49	2059	1239
<i>Vushtrri</i>	82	1743	1632
<i>Zveçan</i>	40	1472	1623
<i>Zubin Potok</i>	23	310	415
Kategoria C			
<i>Graçanicë</i>	31	1035	962
<i>Hani i Elezit</i>	17	902	879
<i>Junik</i>	18	620	872
<i>Klllokot</i>	15	592	670
<i>Obiliq</i>	37	764	1725
<i>Mamushë</i>	17	294	884
<i>Novoberdë</i>	29	603	497
<i>Partesh</i>	16	939	748
<i>Ranilug</i>	16	489	607
<i>Shtime</i>	37	1105	1599

Vërejtje: Numri i zyrtarëve policor në tabelë nuk përfshin numrin e përgjithshëm të tyre në drejtori, por përfshinë vetëm policët e sektorëve, dhe ekipeve patrulluese.

3.18 Patrullat policore të Stacioneve Policore aktivitetet e tyre patrulluese i realizojnë edhe si masë reaktive e të cilat angazhime rrjedhin si rezultat pasi që të ndodhë ndonjë aksident trafiku. Ky angazhim policor i realizuar nga patrullat policore të Stacioneve Policore sjellë rezultatin e ofrimit të sigurisë për pjesëmarrësit tjerë në rrugë. Këto aktivitete Stacionet Policore i zhvillojnë në rrugët lokale dhe urbane duke i trajtuar rastet e trafikut me dëme materiale dhe lëndime të lehta.

² Të dhënat nga raportet e DRP-ve

3.19 Komandantët e stacionit duhet ti caktojë të gjithë policët, përveç ata të cilët punojnë në zbulimin e rasteve kriminalistike, njësitet administrative dhe atyre që punojnë në detyra të posaçme, në njësitet patrulluese.³ Patrullimi i zonës së përgjegjësisë nga Stacionet Policore mbulohet nga njësitet patrulluese të cilat funksionojnë në kuadër të sektorëve sipas metodologjisë të policimit në bashkësi sipas orareve në ndërrime si dhe nga ekipet reaguese që operojnë në kuadër të operativës së Stacioneve Policore.

3.20 Po ashtu edhe mbikëqyrja e respektimit të orarit dhe llogaridhënia për kryerjen e detyrave duhet të aplikohet sipas zinxhirit komandues. Sistemi i ushtrimit të kontrollit ndaj njësive patrulluese nëpër stacione dhe njësi aplikohet nëpërmes procesit të inspektiveve në teren nga ana e menaxhereve policor, kontrolli përmes raportimit me shkrim që aplikohet (forma standarde e këtij raportimi, fletë patrullat dhe raportet e ndërrimeve paraprahe), dhe kontrollit përmes sistemi GPS që kontrollon kohën dhe lokacionet e lëvizjes së veturave të njësitëve patrulluese.

3.21 Kështu që tek stacionet e kategorisë A, numrin më të madh të aksidenteve e ka trajtuar Stacioni Policor Qendra në Prishtinë me **1334** raste të aksidenteve e pasuar nga Stacioni Policor Jugu Prishtinë me **1267** raste, deri sa me më pak aksidente të trajtuara ka pasur Mitrovica e Veriut me vetëm **3** raste të aksidenteve. Kështu që Stacioni Policor Qendra në Prishtinë dhe stacioni Jugu Prishtinë kanë qenë ndër stacionet më të ngarkuara me angazhime sa i përket masave reaktive policore gjë që kërkohet të ketë mbështetje sa i përket burimeve njerzore.

3.22 Në Stacionet Policore të kategorisë B, Stacioni Policor Fushë Kosovës ka trajtuar më së shumti aksidente me **319** raste, e pasuar nga stacioni i Lipjanit i cili ka trajtuar **302** raste të aksidenteve duke u bërë si stacionet më të ngarkuara me angazhime reaktive policore. Numër më të vogël të trajtimit të aksidenteve ka pasur Zubin Potoku me vetëm **7** aksidente. Ndërsa tek Stacionet Policore të kategorisë C më së shumti aksidente të trajtuara ka pasur Stacioni Policor Graqanicë me **143** raste njëherit duke e bërë dhe stacionin me më shumë aktivitete policore reaktive, por duke u përcjellur me më pak angazhime në punë reaktive tek Stacionet Policore Ranilug me **5** raste të aksidenteve si dhe Mamushë e Junikë me nga **7** raste të aksidenteve.

3.23 Po ashtu Stacionet Policore përmes angazhimeve patrulluese kanë trajtuar dhe rastet kundërvajtëse përmes së cilave realizojnë përgjegjësitë e tyre në kategorinë e zbatimit të ligjit. Të dhënat tregojnë se tek kategoria e Stacioneve Policore A, Stacioni Policor Prizren ka shqipëtuat numrin më të madh të kundërvajtjeve me **13.408**, kategoria B, Stacioni Policor Lipjan ka shqipëtuat **6.919** kundërvajtje, kategoria C Stacioni Policor Graqanicë ka shqipëtuat **3.314** kundërvajtje, njëherit duke i bërë si stacionet të cilat aktivitetet e tyre i kanë orijentuar në drejtim të zbatimit të ligjit konkretisht të Ligjit për Kundërvajtje.

3.24 Kurse numrin më të vogël të trajtimit të kundërvajtjeve tek Stacionet Policore të kategorisë A, i ka Leposaviqi me 51 kundërvajtje, ato të kategorisë B, Zubin Potoku me 25 dhe tek Stacionet Policore të kategorisë C, Parteshi ka pasur në trajtim vetëm 75 kundërvajtje. Në tabelën në vijim pasqyrohen angazhimet e zhvilluara nga stacionet policore sa i përket aksidenteve dhe kundërvajtje.

³ Doracaku i Parimeve dhe proceduarave/Parimi P-5.10/I Patrullimi;

Tabela nr. 5. Numri i zyrtarëve policor në raport me angazhimet në trajtimin e aksidenteve dhe tiketat kundërvajtëse⁴.

Stacioni	Polic	Aksidente	Kundervajtje të shqiptuara
<i>Ferizaj</i>	76	701	6.264
<i>Gjakovë</i>	52	309	4.257
<i>Gjilan</i>	106	532	5.425
<i>Leposaviq</i>	77	7	51
<i>Mitrovica e Jugut</i>	65	357	4.004
<i>Mitrovica Veriut</i>	128	3	153
<i>Pejë</i>	90	541	8737
<i>Prishtinë Jugu</i>	81	1.267	5283
<i>Prishtinë Qendra</i>	87	1.334	10.194
<i>Prishtinë Veri</i>	45	459	3.909
<i>Prizren</i>	137	828	13.408
Kategoria B			
<i>Deçan</i>	39	136	764
<i>Dragash</i>	36	76	1.607
<i>Drenas</i>	66	146	4.716
<i>Fushë Kosovë</i>	50	319	6.108
<i>Istog</i>	47	149	959
<i>Kamenicë</i>	63	99	1.797
<i>Kaçanik</i>	35	77	2.258
<i>Klinë</i>	56	199	2.750
<i>Lipjan</i>	51	302	6.919
<i>Malishevë</i>	48	264	6.013
<i>Podujevë</i>	38	299	4.855
<i>Rahovec</i>	46	158	5.493
<i>Skenderaj</i>	63	70	2.526
<i>Suharekë</i>	74	296	5.503
<i>Shterpc</i>	42	17	829
<i>Viti</i>	49	194	2.497
<i>Vushtrri</i>	82	206	2.638
<i>Zveçan</i>	40	20	105
<i>Zubin Potok</i>	23	7	25
Kategoria C			
<i>Graçanicë</i>	31	143	3.314
<i>Hani i Elezit</i>	16	10	825
<i>Junik</i>	18	7	375
<i>Klllokot</i>	15	15	139
<i>Obiliq</i>	37	110	1.426
<i>Mamushë</i>	17	7	640
<i>Novoberdë</i>	29	17	445
<i>Partesh</i>	16	7	75
<i>Ranilug</i>	16	5	159
<i>Shtime</i>	37	88	1.160
Gjithesëj	2.125	9.781	128.605

Vërejtje: Numri i zyrtarëve policor në tabelë nuk përfshin numrin e përgjithshëm të policëve në drejtori, por përfshinë vetëm policët e sektorëve, dhe ekipeve patrulluese.

3.25 Në Stacionet Policore njësit sektoriale krahas detyrave të rëndomta policore janë të ngarkuar me numër mjaft të madh të urdhëresave të gjykatave për ekzekutim të cilat kërkojnë angazhime të konsiderueshme të njërive policore dhe të njëjtat aktivitete shkaktojnë vështirësi për zbatimin e orarit dhe planifikimeve patrulluese.

⁴ Të dhëna nga raportet vjetore të stacioneve policore

3.26 Policia e Kosovës aktivitetet e saja patrulluese përveq që i realizon përmes angazhimit të Stacioneve Policor që janë në varësi të Drejtorive Rajonale, ka të funksionalizuar edhe NJRKRR dhe NJKA të cilat gjithashtu përmes aktiviteteve patrulluese bëjnë ofrimin e sigurisë në rrugë. Andaj sa i përket këtyre dy kategorive strukturore të policisë aktivitetet patrullues, i realizojnë në përputhje me mbulueshmerinë e zonës së përgjegjësive e cila është përgjegjësi e ndarë ndërmjet njësive rajonale të komunikacionit rrugor dhe stacioneve policore. Derisa definimin e zonës së përgjegjësive Stacionet Policore e kanë të përcaktuar në bazë të KM² kufij gjeografik, njësitë rajonale të komunikacionit rrugor dhe njësia për kontrollimin e autostradave zonën e përgjegjësive e kanë të definuar me vijë-gjatësi të rrugëve magjistrale dhe autostradë që e kanë në kontroll.

3.27 Ndërsa nëse i referohemi karakteristikave zonës së përgjegjësive apo gjatësisë së magjistrave që bien në kompetencë të Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor si dhe autostradës që kontrollon Njësia për Kontrollin e Autostradave në raport me numrin e zyrtarëve policor të angazhuar në ato njësi gjendja pasqyrohet si në tabelën në vijim. Po ashtu tabela në fjalë pasqyron edhe numrin e rasteve në raport me numrin e zyrtarëve policor, për periudhën kohore 2014. Shiqur në total në nivel vendi, rrugë magjistrale dhe autosdrdë njësitet rajonale të komunikacionit rrugor dhe ajo autostradës kontrollojnë në total **2666 km**. me gjithsej **405** zyrtar policor të angazhuar nëpër këto njësi dhe me mesatare **6.5 km** për zyrtar policor. Nga totali i rasteve në nivel vendi nga gjithsej **6188** raste, ngarkueshmeria për numër policor mesatarisht i bie **15.2** raste për zyrtarë policor.

Tabela nr. 6. Karakteristikat për NJRKRR dhe NJKA sipas organizimit, shpërndarjes së burimeve njerëzore në raport me zonën e përgjegjësive dhe numrin e rasteve për vitin 2014 ⁵					
NJKRR	Z.Policor	KM	KM/P	Raste	R/P
Prishtina	82	388	4.73	2.992	36.4
Prizreni	50	357	7.14	641	12.82
Ferizaj	40	230	5.75	476	11.9
Mitrovica e Jugut	48	189	3.93	651	13.56
Mitrovica e Veriut	37	118	3.18	134	3.62
Gjilani	50	976	19.52	374	7.48
Pejë	68	302	4.44	684	10.5
NJKA	30	106	3.5	236	7.8
Gjithsejtë	405	2.666	6.5	6.188	15.2

3.28 NJRKRR-të kanë në kompetencë të tyre të gjitha aksidentet me lëndime të rënda dhe me fatalitet të cilat qështje dhe menaxhohen nga kjo njësi policore. Mirëpo kjo vijë ndarëse kompetencash të caktuara në mes Stacioneve Policore dhe NJRKRR-ve, në trajtimin e rasteve në praktikë është theksuar si problematikë për stafin policor pasi që shpeshherë nuk mund të aplikohet apo vlerësohet drejtë se cilat nga rastet mund të kategorizohen si lëndime të lehta apo të rënda nga personeli policor. Vlenë të theksohet që njësitet patrulluese të stacioneve edhe tek rastet e aksidenteve me lëndime të rënda dhe me fatalitet angazhohen në sigurimin e vendit të ngjarjes drejtimit dhe rregullimit të qarkullimit të trafikut.

⁵ Të dhënat nga raportet vjetore të NJRKRR

Foto 4. Drejtimi i trafikut nga oficeri patrullues



3.29 Të gjitha Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor janë pjesë strukturore e Drejtorive Rajonale Policore dhe bazur në këtë ato njëherit i përgjigjen vijës hierarike brenda për brenda Drejtorisë Rajonale. Mirëpo duhet theksuar që politikat zhvillimore sa i përket këtyre njësive realizohen nga ana e Divizionit të Komunikacionit Rrugor i cili është në varësi të drejtpërdrejt me Departamentin për Operacione.

3.30 Nëse ju referohemi numrit të aksidenteve brenda zonave të përgjegjesisë së Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor gjatë vitit 2014, prinë NJRKRR e Prishtinës me numrin më të lartë të aksidenteve me **2992** aksidente e pasuar nga ajo e Pejës me **1004** aksidente. Kurse në zonën e përgjegjesisë së NJRKRR-së në Mitrovicën e Veriut gjatë kësaj periudhe ka pasur numrin me të ulët të aksidenteve në trafik me **134** sosh⁷.

3.31 Gjatë zbatimit të patrullimit brenda zonave të përgjegjesisë së Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor shpeshherë zyrtarët policor hasin në vozitës të cilët duke mos ju përshtatur rregullave të komunikacionit shkaktojnë kundërvajtje. Me qëllim të ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacion, të uljes së kundërvajtjeve në trafik si dhe me qëllim të vetëdijesimit të vozitësve, zyrtarët policor shpeshherë shqiptojnë edhe tiketa ndëshkuese. NJRKRR në Prishtinë kishte shqiptuar numrin më të lartë të kundërvajtjeve në trafik prej 42870 sosh kurse numrin më të ulët të kundërvajtjeve të shqiptuar e kishte NJRKRR e Mitrovicës së Veriut me vetëm 1946 sosh.⁶ Nëse analizohet numri i kundërvajtjeve të shqiptuara në raport me numrin e zyrtarëve policor të inkuadruar nëpër njësi, del se NJRKRR në Prizren e ka normën më të lartë të tiktave të shqiptuara me 752.6 tiketa për polic e pasuar nga NjKA me 697.9 tiketa për polic. Kurse normën me të ulët të kundërvajtjeve të shqiptuara e kishte NJRKRR e Mitrovicës së Veriut me vetëm 52.5 tiketa për polic⁶. *Shih tabelën nr. 7.*

⁶ NJRKRR në Mitrovicën e Veriut si njësi është funksionalizuar në gjysmën e dytë të Vitit 2014;

Tabela nr.7. Karakteristikat për NJRKRR dhe NJKA sipas Aktivitetit patrullues, numrit të aksidenteve, kundërvajtjeve vitin 2014

NJKRR	Zyrtar policor	Plane Operative	Pika Kontrolli	Aksidente	Kundërvajtje trafiku të shqiptuara	Tiketa/polic
Prishtina	82	27	11.306	2.992	42.870	522.8
Prizreni	50	20	7.363	641	37.630	752.6
Ferizaj	40	39	11.232	476	26.818	670.4
Mitrovica e J	48	23	7.194	651	11.780	245.4
Mitrovica V	37	20	3.950	134	1.946	52.5
Gjilani	50	36	10.814	373	26.611	532.2
Pejë	68	53	9.592	1.004	26.447	388.9
NJKA ⁷	30	18	7.265	236	20.937	697.9
Gjithsejtë	405	236	68.716	6.507	195.039	481.5

3.32 Përveç aktiviteteve policore të cilat kanë për qëllim ngritjen e shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor, NJRKRR-të dhe NJKA aktivitet të tyre kanë edhe menaxhimin e aksidenteve të trafikut të cilat rezultojnë: me lëndime të rënda trupore, me fatalitet si dhe të aksidenteve me dëme të mëdha materiale. Pra, menaxhimi i këtyre llojeve të aksidenteve janë në kompetencë ekskluzive të këtyre njësive në të gjitha rrugët dhe në autostradë. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare aksidentet në komunikacionin rrugor të cilat janë menaxhuar nga NJRKRR-të dhe NJKA. Sa i përket numrit të aksidenteve me fatalitet prinë Prishtina me gjithsej **34** aksidente e pasuar nga Peja me **22** aksidente. *Shih tabelën nr.8.*

Tabela nr. 8. Karakteristikat për NJRKRR dhe NJKA sipas aksidenteve për vitin 2014

NJKRR	Aksidente	Aksidente me fatalitet	Aksidente me lëndime dhe dëme materiale
Prishtina	2.992	34	2.958
Prizreni	641	17	624
Ferizaj	476	12	464
Mitrovica e Jugut	651	7	644
Mitrovica e Veriut	134	6	128
Gjilani	373	10	363
Pejë	1.004	22	982
NJKA ⁸	236	3	233
Gjithsejtë	6.507	111	6.396

3.33 Në disa Njësi Rajonale të Komunikacionit Rrugor zhvillohen aktivitete patrulluese nga Njësia e Motoçikletave përmes të cilave patrullime arrihet që të mbulohet menaxhimi i trafikut dhe të ofrohet siguri në rrugë. Gjithashtu kjo njësi zakonisht aktivitetet e saj i zhvillon edhe në raste të përcjelljeve të delegacioneve dhe personaliteteve me rëndësi të veçantë.

⁷ Njësia për Kontrollin e Autostradave;

⁸ Njësia për Kontrollin e Autostradave;

Foto 5. Patrullimi me motoçikletë



3.34 Shpërndarja e personelit patrullues duhet të bëhet në atë mënyrë që të mundësoj një periudhë kohore për veprim preventiv. Kjo kohë duhet të shpenzohet për zgjidhjen e problemeve brenda fushë/ zonës së përgjegjësisë së stacionit apo njësisë përkatëse.⁹ Mirëpo Stacionet Policore dhe NjRKRR-të, ballafaqohen me sfida siç janë numri i madh i personelit të moshuar, angazhimet e shumta në trajnime për stafin, menaxhimi me pushime, gjë që e bënë tejet të vështirë gjendjen me personel policor nëpër ekipe patrulluese gjatë ndërrimeve. Gjatë kohës kur është zhvilluar inspektimi në ndërrim janë hasur diku mesatarisht nga 3, 2 madje ka pas raste edhe me 1 ekip patrulluese në ndërrim. Tejet shqetësues është ndërrimi i tretë (3) ku bazuar në orarët e ndërrimit paraqitet vështirësi e madhe për mbulim dhe funksionalizim të ndërrimit me personel policor të uniformuar.

4. Vlerësimi i veprimeve policore në marrjen e masave pro-aktive në drejtim të ngritjes së sigorisë

4.1 Sipas parimit P-5.10 detyrat e patrullimit përfshijnë segmentin më me rëndësi dhe më të shtrenjtë të policimit. Asnjë shërbim i specializuar nuk i kontribuon me shumë reputacionit dhe shprehjes së vullnetit të mirë të shërbimit se sa njësitet patrulluese. Njësi policor patrullues ekziston për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës. Funkcionet e këtij shërbimi përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në to: të parandaloj paraqitjen e krimit në rrugë duke qenë gjithmonë prezent më shërbimin patrullues, t'u përgjigjen me efikasitet çdo rasti që urgjent kërkon intervenimin e shërbimit policor, për ngritjen e nivelit të parandalimit të krimit duke kryer hetime paraprake tërësore në vendin e ngjarjes, me zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregullave në trafik të pengojnë tollovitë në trafik dhe rreziqet e ndryshme, të intervenoj në rastet e fatkeqësive të komunikacionit, të ndihmojnë viktimave dhe të hulumtojnë shkaqet e aksidentit, ti ndihmojnë qytetarëve rreth problemeve ligjore, shëndetësore, sociale ose humanitare, duke intervenuar vet ose duke i orientuara qytetarët tek agjencionet apo organizatat e caktuara për probleme të tilla, dhe të përforcojnë bashkëpunimin më bashkësinë duke rritur kualitetin dhe kuantitetin e patrullave të policisë.¹⁰

⁹ Doracaku i Parimeve dhe procedurave/Parimi P-5.10;

¹⁰ Doracaku i Parimeve dhe procedurave/Parimi P-5.10/II/ Patrullimi;

4.2 Për menaxhimin e patrullimeve dhe ofrimin e sigurisë në rrugë në tërë territorin e vendit Departamenti për Operacione në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, është përgjegjës për hartimin politikave dhe strategjive qendrore, nxjerrjen e Urdhërave Operative që garantojnë arritjen e synimeve dhe realizimin të objektivave të përcaktuara nga organizata e PK-së. Drejtoritë Rajonale për realizimin dhe materializimin e strategjive dhe planeve strategjike hartojnë plane operative të karakterit regional me përfshirje të njërive dhe stacioneve që janë në varshmërinë e tyre. Niveli lokal i stacioneve policore nxjerrë plane operative të cilat i zbaton me kapacitetet e veta që kanë brenda zonës së tyre të përgjegjësisë.

4.3 Drejtoritë Rajonale, Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Stacionet Policore, aktivitetin e tyre planifikues për marrjen e masave proaktive në drejtim të ngritjes së sigurisë, në menaxhimin me patrullime dhe përgjigjes së situatave gjatë periudhës të vitit 2014, kishte hartuar një mori planesh operative, programe të ndryshme edukative me shkolla, takime të rregullta me KKSB dhe ngritje të memorandumëve me agjencione tjera relevante për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në rrugë.

4.4 Nëse shikohet aktivitetit policor i Njërive Rajonale të Komunikacionit Rrugor si dhe Njësisë për Kontrollin e Autostradave për vitin kalendarik 2014, gjendja pasqyrohet si në tabelën më poshtë. Brenda periudhës kohore 2014, numri i planeve operative për NJRKRR-të nis nga më së paku 20 plane operative (si rasti i NJRKRR-së në Prizren dhe Mitrovica e Veriut) dhe arrin deri në më së shumti 53 plane operative (si rasti i NJRKRR-së në Pejë). NJKA gjatë kësaj periudhe ka pasur 18 plane operative. *Shih tabelën nr.7.*

4.5 Ndër aktivitetet tjera të NJRKRR-ve dhe NJKA-së, me qëllim të ngritjes së shkallës së sigurisë në komunikacionin rrugor pa dyshim se është edhe patrullimi dhe pikat e kontrollit nëpër rrugët brenda zonave të përgjegjësisë të tyre. Gjatë vitit 2014 të dhënat e siguruara gjatë inspektimit tregojnë së NJRKRR në Prishtinë prinë me numrin me të lartë të pikave patrulluese më shifër **11.306** pika kontrolli e pasuar nga NJRKRR në Ferizaj po ashtu me **11.232** pika kontrolli, kurse numrin me të ulët të pikave të kontrollit gjatë kësaj periudhe ka pasur NJRKRR në Mitrovicën e Veriut me **3950** pika kontrolli¹¹. *Shih tabelën nr.9.*

Tabela nr.9. Karakteristikat për NJRKRR dhe NJKA sipas Aktivitetit patrullues, numrit të aksidentëve, kundërvajtjeve dhe tiketave vitin 2014						
NJRKRR	Zyrtar policor	Plane Operative	Pika Kontrolli	Aksidente	Kundërvajtje trafiku të shqiptuara	Tiketa/polic
Prishtina	82	27	11.306	2.992	42.870	522.8
Prizreni	50	20	7.363	641	37.630	752.6
Ferizaj	40	39	11.232	476	26.818	670.4
Mitrovica e J	48	23	7.194	651	11.780	245.4
Mitrovica V	37	20	3.950	134	1.946	52.5
Gjilani	50	36	10.814	373	26.611	532.2
Pejë	68	53	9.592	1004	26.447	388.9
NJKA ¹²	30	18	7265	236	2.0937	697.9
Gjithsejtë	405	236	68.716	6.507	195.039	481.5

4.6 Njësitë relevante kompetente për zbatimin e aktivitetit patrullues në teren varësisht prej nevojave proaktive të aplikimit brenda zonës së përgjegjësisë aplikojnë metodologjinë e patrullimit me vetura, patrullimi me këmbë si dhe varësisht nga sezona aplikohet edhe patrullimi me biçikleta. Ndërsa mënyra e veprimit taktik të zbatimit patrullues nga këto njësi aplikohet me patrullime në lëvizje brenda zonave të përgjegjësisë, si dhe patrullime duke

¹¹ NJRKRR në Mitrovicën e Veriut si njësi është funksionalizuar në gjysmën e dytë të Vitit 2014

¹² Njësia për Kontrollin e Autostradave;

ngritur pika statike të kontrolleve policore nëpër vende të identifikuara si pika të zeza apo nxehta me qëllim të ofrimit të sigurisë në komunikacion ashtu edhe ushtrimin e kontrollit të vendeve të cilat dyshohen se frekuentohen nga kryerësit e mundshëm të veprave të ndryshme penale. Patrullimi me biçiklete nuk është i funksionalizuar në të gjitha stacionet policore për arsye të mungesës së pajisjeve me to si dhe mungesës së stafit të trajnuar për këtë aktivitet patrullues.

4.7 Stacionet Policore të Rendit sa i përket aktiviteteve planifikues për marrjen e masave proaktive në drejtim të ngritjes së sigurisë, menaxhimin me patrullimin dhe përgjigjës së situatave gjatë periudhës së vitit 2014, kishte të hartuar një mori planesh operative. Stacionet Policore të kategorisë A shikuar nga të dhënat e nxjerra del se kanë pasur diku prej **14** plane nga më së paku (stacionit Veri në Prishtinë) e deri në më së shumti **437** plane operative (si rasti i stacionit të Prizrenit). Tek stacionet e kategorisë B, numri i planeve operative brenda vitit 2014, nis nga më së paku me **8** plane operative (si rasti i stacionit të Lipjanit) dhe arrin deri në më së shumti **95** plane operative (si rasti i stacionit të Malishevës). Ndërsa tek stacionet e kategorisë C, numri i planeve operative brenda vitit 2014, nis nga më së paku **4** plane operative (si rasti i stacionit të Parteshit) dhe arrin deri në më së shumti **38** plane operative (si rasti i stacionit të Junikut). *Shih tabelën nr. 10.*

Tabela nr. 10. Karakteristikat për Stacionet Policore të PK-së sipas Aktivitetit patrullues, numrit të policëve, planeve operative 2014

Stacioni	Polic	Plane Operative	Patrullime
Kategoria A			
<i>Ferizaj</i>	76	74	3.276
<i>Gjakovë</i>	52	333	3.050
<i>Gjilan</i>	106	33	4.172
<i>Leposaviq</i>	77	37	4.365
<i>Mitrovica e Jugut</i>	65	63	3.355
<i>Mitrovica e Veriut</i>	128	35	4.634
<i>Pejë</i>	90	154	5.100
<i>Prishtinë Jugu</i>	81	33	7.643
<i>Prishtinë Qendra</i>	87	85	4.066
<i>Prishtinë Veri</i>	45	14	3.094
<i>Prizren</i>	137	437	6.420
Kategoria B			
<i>Deçan</i>	39	46	1.597
<i>Dragash</i>	36	32	2.647
<i>Drenas</i>	66	29	5.171
<i>Fushë Kosovë</i>	50	30	2.440
<i>Istog</i>	47	41	2.196
<i>Kamenicë</i>	63	54	3.690
<i>Kaçanik</i>	35	50	2.683
<i>Klinë</i>	56	56	2.999
<i>Lipjan</i>	51	8	7.569
<i>Malishevë</i>	48	95	3.556
<i>Podujevë</i>	38	47	2.044
<i>Rahovec</i>	46	67	2.171
<i>Skenderaj</i>	64	53	6.556
<i>Suharekë</i>	74	78	3.254
<i>Shterpc</i>	42	16	1.808
<i>Viti</i>	49	38	3.298
<i>Vushtrri</i>	82	81	3.375
<i>Zveçan</i>	40	43	3.095
<i>Zubin Potok</i>	23	15	725
Kategoria C			
<i>Graçanicë</i>	31	7	1.244
<i>Hani i Elezit</i>	16	31	1.781
<i>Junik</i>	18	38	1.492
<i>Klllokot</i>	15	18	1.262
<i>Obiliq</i>	37	13	2.489
<i>Mamushë</i>	17	35	1.178
<i>Novoberdë</i>	29	13	1.100
<i>Partesh</i>	16	4	1.687
<i>Ranilug</i>	16	11	1.096
<i>Shtime</i>	37	23	2.704
<i>Gjthsej</i>	2.125	2.370	126.082

4.8 Gjatë periudhës së inspektimit janë siguruar dhe kërkuar planet operative më të rëndomta të cilat nxjerrin në pah mobilizim dhe aktivitete të shtuara patrulluese për njësitet policore kompetente për fushën e patrullimeve dhe sigurisë në rrugë. Si plane me të shpeshta janë planet operative të sezonës dimërore dhe ato të sezonës verore të cilat sipas specifikave në vete kërkojnë angazhime dhe aktivitete të veçanta policore. Duhet theksuar se Stacionet policore të rendit, NJRKRR-të dhe NJKA përveç planeve operative vetanake, pranojnë dhe realizojnë edhe plane operative nga Drejtoritë Rajonale dhe Divizioni i Komunikacionit Rrugor.

4.9 Gjatë vitit 2014, Stacionet Policore dhe njësitet gjegjëse në kuadër të aktivitetit planifikues për marrjen e masave proaktive në drejtim të ngritjes së sigurisë, menaxhimin me patrullimin

kanë planifikuar dhe aplikuar programe të ndryshme me karakter edukativ dhe preventiv si aktivitetin policor me partneritet me shkolla duke mbajtur ligjërata më nxënës për ngritjen e vetëdijesimit të rinjëve lidhur me ligjet dhe rregullat e trafikut rrugor, vetëdijesimin e nxënësve për dukuritë negative që rrezikojnë të rinjtë mbi përdorimin e substancave narkotike, parandalimin dhe luftimin e huliganizmit nëpër shkolla, si dhe mbi të gjitha ngritjen e partneritetit dhe besimit të qytetarëve tek organizata e PK-së. Veprimtaria e aktivitetit preventiv dhe programet edukative në shkolla, nëpër Stacionet Policore përpilohen nga ana e Njësiteve për Komunitet që operojnë nëpër Stacionet Policore.

4.10 Në të gjitha Stacionet Policore të Rendit janë angazhuar njësi policore të veçanta për tu kujdesur për sigurinë nëpër shkolla dhe hapësirat rreth tyre. Këto njësi operojnë në rroba civile gjatë orarit të punës nëpër këto lokalitete, dhe kanë për detyrë parandalimin dhe luftimin e veprave penale dhe dukurive tjera negative që rrezikojnë mbarëvajtjen e rendit dhe ligjit, jetën dhe shëndetin e nxënësve në shkolla dhe hapësirat rreth tyre.

4.11 Gjatë vitit 2014, Stacionet Policore dhe Njësitet Rajonale të Komunikacionit Rrugor në kuadër të aktivitetit proaktiv në drejtim të ngritjes së sigurisë kishin organizuar programe/fushata të veçanta vetëdijesimi për pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor duke shpërndarë fletushka informimi për ngasësit lidhur me motivimin e tyre për respektim të rregullave të trafikut rrugor, kujdesit gjatë ngasjes së veturave dhe përdorimin adekuat të pajisjeve të nevojshme gjatë ngasjes së automjeteve.

4.12 Njësitet Rajonale të Komunikacionit Rrugor dhe Stacionet Policore zhvillojnë edhe një varg aktiviteteve si: kordinimi dhe mbështetja e njërive tjera policore, bashkëpunimi dhe përkrahja e inspektorateve qendrore dhe lokale si dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që janë të lidhura me çështjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, patrullimet në të gjitha rrugët magjistrale dhe rajonale të ndara sipas zonave të përgjegjësisë. Policët e njësitit patrulluese duhet të kontaktojnë shërbimin e trafikut rrugor për tu këshilluar për ndonjë çështje që ka të bëjë me sigurinë dhe me faktin se mund të paraqes rrezik për qytetarët. Bashkëpunim ndërmjet policisë dhe organeve tjera komunale në kuadër të Stacioneve Policore vlerësohet të jetë i ngushë për shkakun se të gjitha organet komunale dhe agjencionet tjera po thuaj se nuk kryen punë pa kërkuar asistencën e njërive policore. Si rezultat i këtyre aktiviteteve njësitet policore të stacioneve angazhohen pandërprerë në afrimin e asistencave për të gjitha inspektionet, shërbimeve tjera komunale, KEDS-it etj.

4.13 Policët të cilët punojnë në patrulla duhet të njoftohen me rreziqet në trafik, relacionet rrugore dhe territorin nëpër të cilin kalojnë vijat e komunikacionit. Policët po ashtu duhet ti mbledhin informatat e poshtëpërmendura për t'u ndihmuar atyre kur duhet të ofrojnë shërbim qytetarëve: emrat e krimineleve dhe kundërvajtësve të supozuar dhe të dinë vendet ku ata sillen zakonisht, spitalet, ndihmën e shpejtë, ambulancat dhe organizatat tjera shëndetësore që kujdesen për shëndetin e popullsisë, institucionet juridike dhe lokacionet e tyre (të gjitha selitë e gjyqit, zyrat e prokurorit, adresat e mjekësve, lokacionet e shërbimeve sociale, të gjitha bashkësitë tjera e organizatave që janë me rendësi për zbatimin efektiv të ligjit), shërbimi kujdestar ose polici në detyrë duhet të mbajë një libër shënimesh me të gjithë numrat e telefonave të rëndësishëm.¹³ Policët e sektorëve gjatë patrullimit dhe implementimit të strategjisë nacionale të policimit në bashkësi, janë të obliguar të bashkëpunojnë ngushtë me qytetarët, sektorët dhe lagjet e tyre, me qëllim të ngritjes dhe kultivimit të raporteve të partneritetit të ndërsjellët. Gjatë inspektimit njësitet sektoriale kanë filluar së funksionalizuari edhe përkundër vështirësive në burime të mjaftueshme njerëzore, mbështetje logjistike dhe në infrastrukturë. Nëpër dosjet sektoriale të formuara nga sektorët në stacione janë

¹³ Doracaku i Parimeve de proceduarave/Parimi P-5.10/IV/ Patrullimi;

kompletuar informata të rëndësishme për funksionimin e policimit dhe patrullimit në bashkësi. Vështirësi në kompletimin e këtyre dosjeve paraqesin mos zyrtarizimi i vendosjeve të adresave i të gjitha rrugëve urbane dhe lokale proces ky i cili në kohën e inspektimit është në implementim e sipër dhe se policia nuk ka kompetencë në këtë proces.

4.14. Në kuadër të zbatimit të metodologjisë së patrullimit në bashkësi, gjatë inspektimit të IPK-së, rëndësi e veçantë i është kushtuar funksionalizimit të Këshillave Lokale të Sigurisë Në Bashkësi ku nga PK-ja prioritet në këtë drejtim i ishte dhënë lokaliteteve në të cilat kanë popullatë të përzierë. Ndërsa nëpër fshatra dhe lokalitetet tjera ku nuk ka të ngritura KLSP bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet policisë sektoriale zhvillohet me përfaqësuesit apo udhëheqësin e fshatrave. Vlen të theksohet se nëpër disa Stacione Policore ekipet sektoriale kanë arritur të hapin zyre sektoriale në të cilat do të aplikohet orar i caktuar brenda ditës ku do të qëndrojnë policët nga sektorët më qëllim të ofrimit të policisë më afër qytetarit.

5. Analizimi dhe vlerësimi i pajisjeve të njërive operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operacionale për patrullim

5.1 Pa dyshim se për vlerësimin e performancës së zyrtarëve policor ndikojnë edhe kushtet e punës dhe pajisjet me të cilat ata punojnë. Sa i përket kushteve të punës duhet theksuar se në disa stacione policor nuk kanë hapësira të mjaftueshme për punë si dhe disa nga objektet janë të vjetërsuara, si p.sh. Objektet e NJRKRR-ve: Pejë, Prishtinë, Mitrovicë-Veri dhe NJKA. Gjithashtu gjatë inspektimit është vërejtur se personeli i NJRKRR-ve, NJKA-së dhe Stacioneve Policore ballafaqohet me mungesë të disa pajisjeve të nevojshme për punë të cilat reflektojnë në efikasitetin dhe rezultatet e performancës policore. Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelore disa nga pajisjet e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve policore në ofrimin e sigurisë në rrugë.

5.2 Nëse shikohet gjendja ekzistuese me pajisje për NJRKRR-të dhe NJKA varësisht nga regjioni apo njësia situata ndryshon ngase nuk duket të ketë një shpërndarje dhe aq proporcionale me pajisje për punë. Veturat zyrtare të këtyre njërive shikuar për nga numri se sa janë të ngarkuara këto njësi nga gjithsejtë **94** vetura vetëm **55** sosh janë funksionale, të tjerat në kohën e inspektimit kanë rezultuar që ndodhen në Autoparkun e Policisë së Kosovës. Automjetet ekzistuese pothuajse të gjitha që posedojnë këto njësi tani kanë kilometrazh të lartë. Sa i përket furnizimit me motoçikleta nga gjithsejtë **14** motoçikleta vetëm **8** janë në gjendje funksionale si dhe jo të gjitha këto njësi janë të furnizuar me këto mjete lëvizëse për patrullim. *Shih tabelën nr 11¹⁴.*

5.3 Këto njësi janë të furnizuar edhe me një numër të kompjuterëve laptop për përdorim të patrullave në terren por nga të dhënat e mbledhura gjatë këtij inspektimi prej **33** copë asnjë nuk është në gjendje funksionale. Prej **124** kamerave digjitale vetëm **87** sosh janë funksionale, prej **107** laserëve për matjen e shpejtësisë (radar) **61** janë funksional, prej **47** alkotestave vetëm **27** sosh janë funksional. Sa i përket pajisjeve të laserëve për matjen e shpejtësisë si dhe alkotestevë, gjatë inspektimit janë siguruar dëshmi se këto dy këto lloje të pajisjeve ishin të kalibruara dhe posedonin certifikata mbi kalibrimin e tyre. Shikuar në tërësi furnizimi me pajisje për këto njësi gjendja e pasqyruar në tabelë tregon për një shpërndarje jo proporcionale të pajisjeve për së cilën njësi.

¹⁴ Shifrat e vendosura në tabelat me nr. 11, 12,13 dhe 14 të shënuara pa kllapa tregojnë pajisjet me të cilat janë të furnizuara këto njësi ndërsa shifrat e vendosur brenda kllapave tregojnë pajisjet të cilat janë në gjendje funksionale;

Tabela nr. 11. Pajisjet për punë të NJRKRR-ve dhe NJKA¹⁵

NJTRRK	Automjete	Motoçikleta	Alkootest	Kamera digjitale	Radr-laser	Videokamera	Laptop në automjet	iritq	Bateri dore	Stop dore	Kona
<i>Ferizaj</i>	12 [7]	4 [2]	6 [6]	7 [6]	7 [6]	0	6 [0]	0	54	54	25
<i>Gjakovë</i>	4 [3]	0	1 [1]	3 [3]	5 [2]	0	4 [0]	0	23	23	4
<i>Gjilan</i>	10 [7]	1 [1]	5 [2]	10 [9]	22 [8]	0	4 [0]	1 [1]	60	63	20
<i>Mitrovica V</i>	6 [4]	0	2 [1]	5 [5]	6 [6]	5 [5]	0	0	43	30	8
<i>Mitrovica J.</i>	14 [6]	0	6 [3]	15 [14]	14 [6]	2 [1]	5 [0]	3 [2]	59	59	12
<i>Prizreni</i>	11 [6]	4 [4]	12 [5]	9 [5]	19 [10]	2 [2]	8 [0]	0	2	62	36
<i>Pejë</i>	9 [5]	5 [1]	6 [2]	23 [11]	13 [7]	23 [11]	6 [0]	1 [1]	64	60	10
<i>Prishtinë</i>	20 [11]	0	7 [5]	38 [20]	11 [8]	0	0	2 [2]	85	106	44
<i>NJKA</i>	8 [6]	0	2 [2]	14 [14]	10 [8]	0	0	0	40	40	12
<i>Gjithsej</i>	94 [55]	14 [8]	47 [27]	124 [87]	107 [61]	32 [19]	33 [0]	7 [6]	430	497	171

5.4 Edhe nëpër Stacione Policore sikur në NJRKRR, gjendja ekzistuese me pajisje paraqitet me karakteristikat e njëjta si në këto të fundit. Për Stacionet Policore të kategorisë “A” nga të dhënat e mbledhura gjendja aktuale e pajisjeve duket si në tabelën në vijim. Nga total **172** vetura sa janë të ngarkuara prej tyre **90** janë funksionale dhe në qarkullim në shërbim të njërive policore ndërsa **82** sosh janë jashtë qarkullimit, për shkak të defekteve dhe të njëjtat ndodhën në servisin e autoparkut policor. Nga gjithsejtë **69** biçikleta vetëm **47** prej tyre janë funksionale. Sa i përket shpërndarjes së biçikletave jo të gjithë stacionet janë të pajisura me këto mjete të nevojshme për kryerjen e aktivitetit patrulluese. Bazuara sipas këtyre të dhënave këto stacione të kësaj kategorie nuk janë të furnizuar fare me pajisjet për ndaljen e dhunshme të automjeteve. Prej **99** kamerave digjitale vetëm **63** sosh janë funksionale. Nga **12** videokamera **9** nga to janë funksionale, prej **24** laserëve për matjen e shpejtësisë, **16** janë funksional, prej **33** alkotestave vetëm **16** sosh janë funksional. *Shih tabelën nr. 12.*

¹⁵ Të dhënat e siguruar nga stacionet policore

Tabela nr.12 Pajisjet ndihmëse të policisë nëpër stacione të Kategorisë "A" ¹⁶											
Stacioni	Automjete	Biçikleta	Alkootest	Kamera digjitale	Radr-laser	Videokamera	Laptop në automjet	Iriq	Bateri dore	Stop dore	Kona
<i>Ferizaj</i>	21 [9]	5 [5]	1 [1]	11 [7]	1 [1]	0	0	0	143	0	2
<i>Gjakovë</i>	16 [9]	4 [2]	1 [1]	5 [3]	2 [1]	0	0	0	94	0	16
<i>Gjilan</i>	25 [8]	8 [6]	2 [2]	12 [9]	3 [3]	1 [1]	0	0	0	2	0
<i>Leposaviq</i>	11 [7]	0	0	5 [3]	2 [1]	0	0	0	119	0	60
<i>Mitrovica e Jugut</i>	11 [9]	10 [8]	1 [0]	10 [7]	1 [1]	1 [1]	0	0	121	10	5
<i>Mitrovica Veriu</i>	9 [5]	0	0	2 [2]	0	0	0	0	123	0	5
<i>Pejë</i>	22 [7]	9 [0]	2 [2]	13 [8]	2 [2]	2 [1]	0	0	0	0	15
<i>Prishtinë Jugu</i>	8 [8]	7 [7]	2 [2]	8 [8]	2 [2]	1 [1]	0	0	130	10	12
<i>Prishtinë Qendra</i>	15 [10]	11 [11]	16 [1]	7 [4]	4 [2]	2 [1]	0	0	128	11	25
<i>Prishtinë Veri</i>	18 [7]	8 [8]	1 [1]	5 [3]	4 [0]	2 [1]	0	0	100	0	20
<i>Prizren</i>	16 [11]	7 [0]	7 [6]	21 [9]	3 [3]	3 [3]	0	0	2	7	35
<i>Gjithsejtë</i>	172 [90]	69 [47]	33 [16]	99 [63]	24 [16]	12 [9]	0	0	960	40	195

5.5 Për Stacionet Policore të kategorisë "B" nga total **179** vetura sa janë të ngarkuara prej tyre **76** janë funksionale dhe në qarkullim në shërbim të njësive policore ndërsa **103** sosh janë jashtë qarkullimit, për shkak të defekteve dhe të njëjtat ndodhën në servisën e autoparkut policor. Nga gjithsejtë **69** biçikleta vetëm **58** prej tyre janë funksionale. Bazuara sipas këtyre të dhënave këto stacione të kësaj kategorie vetëm 3 stacione janë të furnizuar me pajisjet për ndaljen e dhunshme të automjeteve. Prej **90** kamerave digjitale vetëm **59** sosh janë funksionale, prej **18** videokamerave **14** sosh janë funksionale. Nga gjithsej **32** laser për matjen e shpejtësisë **25** janë funksional, prej **52** alkotestave vetëm **27** sosh janë funksional. *Shih tabelën nr. 13.*

¹⁶ Të dhënat e siguruar nga stacionet policore

Tabela nr.13 Pajisjet ndihmëse të policisë nëpër stacione të Kategorisë "B" ¹⁷											
Stacioni	Automjete	Bicikleta	Alkootest	Kamera digjitale	Radr-laser	Videokamer	Laptop ne automjet	Iriq	Bateri dore	Stop dore	Kona
Deçan	8 [2]	0	1 [0]	2 [1]	1 [1]	1 [0]	1 [0]	0	57	0	20
Dragash	6 [2]	0	4 [2]	3 [1]	2 [2]	1 [1]	0	0	54	0	30
Drenas	7 [2]	10 [6]	1 [1]	3 [2]	2 [1]	1 [1]	0	2 [2]	82	0	9
Fushë Kosovë	6 [2]	2 [2]	1 [1]	3 [3]	2 [2]	1 [1]	0	0	27	5	26
Istog	8 [2]	6 [5]	6 [0]	2 [2]	1 [1]	1 [1]	0	0	69	0	2
Kamenicë	13 [3]	4 [4]	1 [1]	5 [3]	3 [3]	1 [1]	0	0	86	5	105
Kaqanik	11 [5]	6 [5]	6 [1]	7 [3]	2 [1]	3 [3]	0	1 [1]	49	0	20
Klinë	9 [5]	4 [4]	2 [1]	7 [7]	1 [1]	1 [1]	0	1 [1]	79	7	90
Lipjan	17 [5]	7 [7]	2 [2]	2 [2]	2 [2]	1 [1]	0	0	101	2	20
Malishevë	6 [4]	4 [4]	3 [3]	6 [6]	1 [1]	0	0	0	1	3	20
Podujevë	7 [7]	6 [6]	2 [1]	8 [6]	2 [2]	0	0	0	87	0	20
Rahovec	6 [4]	0	4 [3]	5 [3]	1 [1]	0	0	0	60	0	20
Skenderaj	13 [2]	5 [3]	1 [1]	7 [7]	2 [1]	1 [1]	0	0	96	0	5
Suharekë	6 [6]	6 [3]	4 [2]	3 [2]	4 [2]	0	0	0	93	0	22
Shterpc	8 [5]	0	3 [3]	3 [2]	2 [1]	1 [0]	0	0	54	2	10
Viti	9 [4]	4 [4]	8 [2]	13 [2]	2 [1]	2 [1]	0	0	0	0	4
Vushtrri	15 [6]	5 [5]	1 [1]	4 [3]	1 [1]	1 [1]	0	0	110	2	10
Zveçan	13 [5]	0	1 [1]	2 [2]	0	1 [1]	0	0	55	0	0
Zubin Potok	11 [8]	0	1 [1]	3 [2]	2 [1]	1 [0]	1 [1]	0	69	0	0
Gjithsejtë	179 [76]	69 [58]	52 [27]	90 [59]	32 [25]	18 [14]	2 [1]	4 [4]	1229	26	433

5.6 Për Stacionet Policore të kategorisë "C" nga total **38** vetura sa janë të ngarkuara prej tyre **23** janë funksionale dhe në qarkullim në shërbim të njërive policore ndërsa **15** sosh janë jashtë qarkullimit, për shkak të defekteve dhe të njëjtat ndodhën në servis e autoparkut policor. Nga gjithsejtë **11** biçikleta të gjitha prej tyre janë funksionale. Bazuara sipas këtyre të dhënave këto stacione të kësaj kategorie asnjë nga to nuk janë të furnizuara me pajisjet për ndaljen e dhunshme të automjeteve. Prej **21** kamerave digjitale vetëm **20** sosh janë funksionale, prej **3** videokamerave të gjitha janë funksionale dhe janë vetëm **3** stacione që posedojnë nga një lloj të kësaj pajisje ndërsa 7 stacione tjera fare nuk posedojnë me to. Nga **11** laserë për matjen e shpejtësisë **9** janë funksional, prej **8** alkotestave vetëm **6** sosh janë funksional. *Shih tabelën nr.14.* Pajisjet të laserëve për matjen e shpejtësisë si dhe alkotestevë, janë siguruar dëshmi se të dy këto lloje të pajisjeve në kohën e inspektimit ishin të kalibruara dhe posedonin çertifikata mbi kalibrimin e tyre.

¹⁷ Të dhënat e siguruar nga stacionet policore

Tabela nr.14 Pajisjet ndihmëse të policisë nëpër stacione të Kategorisë "C"¹⁸

Stacioni	Automjete	Biçikleta	Alkootest	Kamera digjitale	Radr-laser	Videokamera	Laptop ne automjet	Iriq	Bateri dore	Stop dore	Kona
<i>Graçanicë</i>	5 [3]	2 [2]	1 [0]	1 [1]	1 [1]	0	0	0	44	0	10
<i>Hani i Elezit</i>	3 [2]	0	1 [1]	2 [2]	1 [1]	0	0	0	18	0	6
<i>Junik</i>	2 [2]	0	0	1 [1]	1 [1]	1 [1]	0	0	0	4	4
<i>Kllokot</i>	2 [2]	0	0	2 [2]	1 [1]	0	0	0	22	2	4
<i>Obiliq</i>	8 [2]	6 [6]	1 [1]	4 [3]	2 [0]	1 [1]	0	0	37	0	45
<i>Mamushë</i>	1 [1]	0	0	1 [1]	1 [1]	0	0	0	19	0	45
<i>Novoberdë</i>	3 [3]	1 [1]	2 [2]	2 [2]	1 [1]	0	0	0	34	2	6
<i>Partesh</i>	3 [2]	0	0	2 [2]	1 [1]	0	0	0	12	1	3
<i>Ranilug</i>	1 [1]	0	1 [1]	2 [2]	1 [1]	0	0	0	26	1	4
<i>Shtime</i>	10 [5]	2 [2]	2 [1]	4 [4]	1 [1]	1 [1]	0	0	44	0	20
<i>Gjithsej</i>	38 [23]	11 [11]	8 [6]	21 [20]	11 [9]	3 [3]	0	0	256	10	147

5.7 Policët duhet të bartin jelek reflektues ose pelerina karakteristike kur e drejtojnë trafikun gjatë inspektimit ku në të gjitha njësitë dhe Stacionet Policore kemi siguruar që janë të pajisur se cili polic me jelek reflektues. Bateritë me drita fluoeshente duhet të përdoren gjatë orarit të natës sa herë që është e mundur ku të dhënat e siguruar në njësitë dhe stacionet e inspektuara tregojnë se shumica dërmuese e policëve janë të furnizuar me këto pajisje në përjashtim të një numri të vogël të stacioneve të cilat nuk janë të furnizuar me këto pajisje si (Gjilan,Pejë, Viti, Malishevë dhe Junik etj.).

¹⁸ Të dhënat e siguruar nga stacionet policore

6. Përfundimi

6.1 Nga inspektimi i kryer në fushën e Menaxhimit të patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë, IPK-ja ka nxjerrë në pah gjendjen aktuale të funksionimit të Policisë së Kosovës, duke identifikuar punën dhe praktikën e mira që aplikon kjo organizatë. Po ashtu janë evidentuar vështirësitë dhe ngeçjet me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe aktivitetit policor dhe pas vlerësimit të gjendjes në terren, IPK-ja ka dhënë rekomandime të nevojshme menaxherëve të strukturës policore, kompetent për marrjen e veprimeve drejtë përmirësimit të performancës policore.

6.2 Struktura Organizative e Policisë së Kosovës në fuqi, (të datës 25 maj 2012) ka paraparë organizimin dhe funksionimin e njësive në kuadër të kësaj strukture, organizimin dhe shpërndarjen e numrit të personelit policor sipas detyrave dhe përgjegjësitë e punës. Funkcionalizimi i Stacioneve Policore dhe plotësimi i pozitave me personel policor sipas Strukturës Organizative, vazhdon të mbetet një nga të metat e vazhdueshme të PK-së. Kështu që disa Stacione Policore kanë arritur që të tejkalojnë numrin maksimal dhe disa tjera nuk kanë të plotësuar as numrin minimal të personelit që e kanë të përcaktuar konform listës së personelit të bashkangjitur në strukturën organizative në fuqi.

6.3 Bazuar sipas strukturës organizative, Stacionet Policore janë të kategorizuara në tri kategori "A", "B" dhe "C". Kriteret përcaktues për të vendosur këtë kategorizim janë konsideruar tiparët dhe karakteristikat gjeografike, demografike dhe specifika tjera. Disa Stacione Policore bazuar nga karakteristikat dhe specifikat e stacioneve, vlerësimi në kategorizimin e tyre nuk i përgjigjet nevojave dhe obligimeve që ballafaqohen stacionet e caktuara. Andaj, është vërejtur se tek disa raste të stacioneve të caktuara kërkohet një rivlerësim lidhur me kategorizimin e tyre me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit policor. Ndërsa sa i përket Drejtorisë Rajonale Mitrovicë Veriu, DPP ende nuk ka rritur që të azhurnojë të dhënat me qëllim që të bëjë kategorizimin zyrtar të kësaj drejtorie në përputhjen me Strukturën Organizative.

6.4 Ndarja e kompetencave ndërmjet Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor me Stacionet Policore sa i përket menaxhimit me aksidentet në praktikë shfaqë një problematikë ngase në momentin e ndodhjes së aksidenteve shpesh herë është e vështirë të cilësohet se a është aksident me lëndime të lehta apo të rënda apo cili aksident konsiderohet me dëme të mëdha materiale e cili me dëme të vogla materiale. Një rregullore apo procedurë standarde e operimit e cila do të përcaktonte qartë vijën ndarëse të këtyre kompetencave do të mënjanonte paqartësitë e mundshme lidhur me këtë çështje.

6.5 Njësitet policore kompetente për zbatimin e aktivitetit patrullues në terren varësisht prej nevojave, praktikave të aplikimit brenda zonës së përgjegjësisë aplikojnë metodologjinë e patrullimit me vetura, patrullimi me këmbë si dhe varësisht nga sezona aplikohet edhe patrullimi me biçikleta si dhe sipas specifikave dhe në përputhje me bazën ligjore angazhohet edhe Njësia e Motoçikletave. Por në praktikë jo gjitha Stacionet Policore për arsye të mungesës së pajisjeve dhe mungesës së stafit të trajnuar për këtë aktivitet patrullues e kanë të funksionalizuar njësitet e patrullimit me biçikleta. Po ashtu përkundër vështirësive dhe gjendjes së vështirë me automjete për njësitet policore patrulluese menaxherët policor nëpër stacione duhet të gjejnë mënyra motivuese për plotësimin e plotë të orarëve patrullues duke aplikuar metodologjinë e patrullimeve në këmbë me qëllim të zbatimit të planeve dhe përmbushjes së detyrave policore.

6.6 Policia e Kosovës ka arritur të ndërmarrë një mori masash proaktive në drejtim të menaxhimit të patrullimeve në trafik. Ndërsa policët e sektorëve gjatë patrullimit dhe implementimit të strategjisë nacionale të policimit në bashkësi, janë angazhuar që të

bashkëpunojnë ngushtë më me qytetarët, sektorët dhe lagjet e tyre, më qëllim të ngritjes dhe kultivimit të raporteve të partneritetit të ndërsjellët. Ngritja e Këshillave Lokale të Sigurisë në Bashkësi gradualisht e çdo ditë po funksionalizohet ku prioritet në këtë drejtim i është dhënë lokaliteteve në të cilat kanë popullatë të përzierë. Ndërsa nëpër fshatra dhe lokalitetet tjera ku nuk ka të ngritura KLSP bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet policisë sektoriale zhvillohet me përfaqësuesit apo udhëheqësinë e fshatrave. Ky segment i bashkëpunimit të ndërsjellët shpesh sjellë rezultate nga i cili dalin nevoja të shtimit të aktiviteteve patrulluese nëpër zona dhe lokalitete të caktuara varësisht nga problemet dhe kërkesat që shtrojnë banoret në kuadër të këtyre aktiviteteve.

6.7 Në vlerësimin e performancës së zyrtarëve policor kanë ndikuar edhe kushtet e punës dhe pajisjet me të cilat punojnë njësitë patrulluese në terren. Gjatë inspektimit është vërejtur se personeli i NJRKRR-ve, NJKA-së dhe Stacioneve Policore ballafaqohet me mungesë të disa pajisjeve të nevojshme për punë të cilat reflektojnë në efikasiteti dhe rezultatet e performancës policore si dhe është vërejtur shpërndarje jo proporcionale e pajisjeve të njësisve operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operationale për patrullim. Pastaj gjendja ekzistuese e pajisjeve të njësisve dhe Stacioneve Policore është jo e kënaqshme ngase shumë prej këtyre pajisjeve në kohën kur është zhvilluar inspektimi ishin në gjendje jo funksionale për shkak të vjetërsisë dhe mosmirëmbajtjes adekuate të tyre.

7. Rekomandimet:

1. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe Stacionet Policore të angazhohen maksimalisht në funksionalizimin të Strukturës Organizative, plotësimi i pozitive me personel policor të uniformuar.*
2. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike që të rishqyrtoj proceduarat dhe kriteret e kategorizimit të disa nga Stacionet Policore të cilat për shkak të specifikave dhe kushteve të hapësirave gjeografike, numrit të madh të popullsisë brenda zonave të përgjegjësive kategorizimi i tyre nuk i përgjigjet nevojave dhe kërkesave karshi kapaciteteve momentale të burimeve policore.*
3. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike si dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugor të angazhohen në hartimin e një Procedure Standarde të Operimit e cila do të definojë saktë kompetencën e menaxhimit me rastet e aksidenteve të trafikut ndermjet NjRKRR-ve dhe Stacioneve Policore ngase ndarje e tillë e cila aplikohet në praktikë është mjaftë e paqartë për të defnuar në momentet kur ndodhin aksidentet së cilat aksidente konsiderohen me lëndime të e cilat me lëndime të rënda apo dëme të lehta dhe dëme të rënda materiale;*
4. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe të gjitha Stacionet Policore të angazhohen më shumë me qëllim të ngritjes dhe funksionalizimit të njësitit të biçikletave i cili do të ushtronte aktivitet patrullues gjatë sezonës së verës,*
5. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon të gjitha Stacionet Policore përkundër vështirësive që kanë me pajisjen me vetura të inkurajon maksimalisht zbatimin e aktivitetit patrullues nëpër njësitë sektoriale me patrulla në këmbë.*
6. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe Stacionet Policore të angazhohen maksimalisht dhe të japin kontributin e tyre drejt ngritjes dhe funksionalizimit të Këshillave Lokale të Sigurisë në Bashkësi në të gjitha lokalitetet ku plotësohen kriteret dhe nevojat për ekzistimin e tyre.*
7. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike si dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugorë të angazhohen për shpërndarje unike dhe proporcionale të pajisjeve të njësisve operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operacionale për patrullim.*

8. Plani i Veprimit i PK-se për Përmbushjen e Rekomandimeve të IPK-se

Nr.	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet	Plani i veprimit
1	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe Stacionet policore të angazhohen maksimalisht në funksionalizimin të strukturës organizative plotësimi i pozitave me personel policor të uniformuar.</i></p>	<p><i>I lartë</i></p>	<p><i>Rekomandimi është i bazuar, real dhe i arritshëm. Për realizimin e tij, Divizioni për Siguri Publike gjithnjë propozon menaxhmentit të lartë ndryshimet strukturore bazuar në dinamikën e zhvillimit të PK-së dhe detyrave dhe aktiviteteve policore. Propozimet tona në të kaluarën kanë qenë që kategorizimi i stacioneve policore të zbërthehet në gjashtë kategori dhe jo në tri, të shihen nënstationet dhe në vend të tyre të kategorizohen në nivelin e sektorit policor, po ashtu janë bërë propozimet që të fuqizohen qendrat e komunikimit aty ku ka mundësi, dhe ku ato mund të jenë operacionale (Shembull: për tri st. pol. Veri, Qendër dhe Jug, qendra e komunikimit e DRP-Prishtinës dhe Trafikut Rajonal të udhëhiqen nga një Qendër Komunikimi), qendrat e mbajtjes të funksionojnë në nivel Regjional nga një qendër. Nga këto ristrukturime përfitojmë në personel për nevojat operacionale. Gjithashtu ka iniciativë që numri i policëve në sigurimin e Objekteve të zvogëlohet, dhe në këtë mënyrë Policia e Kosovës, këta zyrtarë të angazhohen në plotësimin e strukturës organizative aty ku është e nevojshme. Vlen të ceket që në staf menaxhues gjithnjë jemi aktiv me propozimet tona për një strukturë më efektive.</i></p>	<p><i>Aktivitet në progres dhe jo i limituar në kohë. Ndryshimet strukturore janë dinamike dhe të përhershme.</i></p>

2	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike që të rishqyrtoj proceduarat dhe kriteret e kategorizimit të disa nga stacionet policore të cilat për shkak të specifikave dhe kushteve të hapësirave gjeografike, numrit të madh të popullsisë brenda zonave të përgjegjesisë kategorizimi i tyre nuk i përgjigjet nevojave dhe kërkesave karshi kapaciteteve momentale të burimeve policore.</i></p>	<p><i>I mesëm</i></p>	<p><i>Në komentet te cilat i dhash në rekomandimin e parë janë dhënë sqarimet ne lidhje me iniciativat. Struktura e tanishme është bazuar nga një hulumtim njëvjeçar në vitin 2011 i formuar dhe i udhëhequr nga ekspert ndërkombëtar, të cilët i kanë propozuar Policisë së Kosovës bazuar në parametrat që ju i keni trajtuar gjatë inspektimit. Kapacitetet e burimeve njerëzore të Policisë së Kosovës në disa raste përcaktohen nga vendimet politike pa ndonjë nevojë operaconale. Këtu vlen të ceket: Formimi i Njësisë së Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare me mbi 200 polic, pastaj integrimi i policëve të MUP-it të Serbisë në Policinë e Kosovës gjithsejtë 287 pjesëtar të cilët sipas marrëveshjes mund te caktohen ne detyre vetëm ne DRP Mitrovice Veri, etj. Kjo ka ndikuar në shpërndarjen jo racionale të personelit, si dhe angazhimi i policëve jashtë detyrave primare policore etj.</i></p>	<p><i>Ne do ti ri-përsërisim iniciativat dhe propozimet tona për ndryshime. Realizimi i rekomandimit nuk përcaktohet</i></p>
3	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike si dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugor të angazhohen në hartimin e një Procedure standarde të Operimit e cila do të definojnë saktë kompetencën e menaxhimit me rastet e aksidenteve të trafikut ndermjet NjRKRR-ve dhe stacioneve policore ngase ndarje e tillë e cila aplikohet në praktikë është mjaftë e paqartë për të definuar në momentet kur ndodhin aksidentet së cilat aksidente konsiderohen me lëndime të e cilat me lëndime të rënda apo dëme të lehta dhe dëme të rënda materiale;</i></p>	<p><i>I lartë</i></p>	<p><i>Është rekomandim shumë i qëlluar. Ne do të marrim iniciativat që të formulohet Procedura Standarde e Operimit dhe të përcaktohen parametrat dhe kriteret në lidhje me menaxhimin e aksidenteve në trafik. PSO të autorizohet nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve. Për momentin menaxhimi i aksidenteve bazohet në Udhëzuesin e trafikut (2012) si dhe Parimeve dhe Procedurave P-5.18.</i></p>	<p><i>Afati I realizmit të rekomandimit 01.10.2015</i></p>

4	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe të gjitha Stacionet policore të angazhohen më shumë me qëllim të ngritjes dhe funksionalizimit të njësitit të biçikletave i cili do të ushtronte aktivitet patrullues gjatë sezonës së verës</i></p>	<p><i>I lartë</i></p>	<p><i>Pajtohem plotësisht me rekomandimin. Pengesa në realizimin e këtij rekomandimi është pajisja dhe servisimi i biçikletave si dhe trajnimi i personelit. Rreth pajisjes me biçikleta ka dështuar tenderi për blerjen e tyre, ndërsa në lidhje me trajnimin e policeve deri tani nuk ka pasur interes në mënyrën e duhur që ne këtë trajnim të aplikojnë policët, por tani gjeneratat e policëve të rinj kanë shprehë dëshirë që në masë të madhe të trajnohen në drejtimin e biçikletave dhe të jenë pjesë e këtyre ekipeve, pas realizimit të trajnimit të tyre fushor I cili zgjate dy vjet nga trajnimi themelor në Vushtrri. Ne kemi ndërmarr iniciativa që të formohen edhe njësi të motoçikletave për patrullim, tani gjendemi në fazën e tenderimit për këto pajisje.</i></p>	<p><i>Afati viti 2016 gjashtëmuji i dytë.</i></p>
5	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon të gjitha Stacionet policore përkundër vështirësive që kanë me pajisjen me vetura të inkurajon maksimalisht zbatimin e aktivitetit patrullues nëpër njësitë sektoriale me patrulla në këmbë</i></p>	<p><i>I lartë</i></p>	<p><i>Plotësisht pajtohem me rekomandimin e juaj. Misioni EULEX I ka dhuruar 37 automjete Policisë së Kosovës, 27 nga këto automjete do të ju shpërndahen St. Policore dhe DRP –ve. Tani jemi në fazën finale e vlerësimit të tenderit për automjete policore, me dinamik të liferimit vjetor nga operatorët për 50 automjete për katër vitët e ardhshme. Më lartë e ceka që në te njëjtën kohë jemi në proces edhe për motoçikleta dhe biçikleta. Në këto katër vitet e fundit Policia e Kosovës nuk është furnizuar me automjete policore, arsyeja dështimi i tenderimit. Ne si Divizion i Sigurisë Publike që tri vite me radhë i kemi parashtruar kërkesat tona për 140 automjete policore, 100 motoçikleta deri në 150 cc, dhe 150 biçikleta dhe pajisje tjera policore të cilat nuk specifikohen në këtë rekomandim.</i></p>	<p><i>Ne do të riperserisim iniciativat dhe propozimet tona për ndryshime. Realizimi i rekomandimit nuk përcaktohet.</i></p>

6	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike, Drejtoritë Rajonale të PK-së dhe Stacionet policore të angazhohen maksimalisht dhe të japin kontributin e tyre drejt ngritjes dhe funksionalizimit të Këshillave Lokale të Sigurisë në Bashkësi në të gjitha lokalitetet ku plotësohen kriteret dhe nevojat për ekzistimin e tyre.</i></p>	<p><i>I mesëm</i></p>	<p><i>Me fillimin e implementimit të Strategjisë së Policimit në Bashkësi, ka iniciativa te formimit të Këshillave Lokale për Siguri Publike (KLSP). Iniciues për formimin e tyre është Komandanti I Stacionit Lokal dhe komuniteti i Lokalitetit të Caktuar, kurse vendimin ne lidhje me formimin e KLSP-ve e merr Drejtori i Përgjithshëm I Policisë. Në vitet e fundit për çdo vit janë formuar 5 deri në 6 KLSP në te gjithë territorin e Kosovës, kurse në vitin 2015 janë formuar gjithsejtë 10 KLSP. Gjate këtij viti dhe vitin vijues prioritet është formimi dhe funksionalizimi I KLSP-ve në Veri të Kosovës, gjegjësisht në Regjionin e DRP Mitrovicë Veri, por edhe ne Rajonet tjera. Formimi i KLSP-ve është iniciativë e qytetarëve, komunitetit dhe Komandanti t të Stacionit Policor, bazuar në parametrat e sigurisë dhe nevojave të komunitetit në zgjidhjen e përbashkët të problemeve të sigurisë. Deri me tani në të gjithë territorin e Kosovës janë formuar dhe funksionalizuar 48 KLSP. Sipas parashikimeve tona ky numër vazhdimisht do te rritet, varësisht prej nevojave që paraqiten.</i></p>	<p><i>Objektivi permanent dhe afatgjatë në vijimësi.</i></p>
7	<p><i>Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Divizionit për Siguri Publike si dhe Divizionit të Komunikacionit Rrugorë të angazhohen për shpërndarje unike dhe proporcionale të pajisjeve të njësive operative dhe mjeteve tjera të nevojshme operacionale për patrullim.</i></p>	<p><i>I lartë</i></p>	<p><i>Të gjitha pajisjet për Njësitë Rajonale te Komunikacionit Rrugor dhe Njësinë për Kontrollin e Autostradave, sa i përket furnizimit dhe shpërndarjes realizohen nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor, pas vlerësimit të nevojave për pajisje për të gjitha njësitë, përveç donacioneve të cilat me kërkesë të donatorit shpërndarja bëhet bazuar në kërkesën e donatorit.</i></p>	<p><i>Realizimi është në vazhdimësi.</i></p>